

# GAZETA SHQIPTARE



Kryeredaktor: Erl MURATI  
Zv/kryeredaktore - Rezarta DELISULA  
Tel:(04)2359-104, Fax:(04) 2359-116 E-mail:gazetashqiptare@hotmail.com



Viti XXIV - Nr. 7676 E enjte 11 Tetor 2018 Çmimi, 50 lekë (1.5 euro)

Opinion

Ditës

Këto ditë e fundit kanë tërhequr vëmendjen katër ngjarje të rëndësishme ndërkombëtare, në dukje rastësore, por ngushtësisht të lidhura në ...  
Vijon në faqen 20

Nga JORGJI KOTE

Drejt "shkurorëzimit" të GDP-së?



Opinion

Ditës

Tallja me ndjenjat e shqiptarëve në FYROM vazhdon. Referendumi në këtë vend nxori frustrimet e qytetarëve sllavo-maqedonas, të cilët e kanë ...  
Vijon në faqen 21

Nga ARSIM SINANI

Shtatë gabimet e Zaevit



Formula që nxjerr masën e përfitimit

## Indeksimi i pagave, dalin koeficientët e përlogaritjes së pensioneve për 2018

Hyn në fuqi vendimi i qeverisë, shembujt si të mësoni shumën e parave që ju takon

Qeveria ka miratuar koeficientët e rinj të indeksimit të pagave për vitin 2018, në bazë të së cilëve do të përlogariten pensionet. Vendimi i Këshillit të Ministrave është publikuar ditën e djeshme në Fletoren Zyrtare dhe ka hyrë në fuqi menjëherë. "Gazeta Shqiptare" publikon sot tabelën me koeficientët e rinj të indeksimit, sipas ...  
Në faqen 11

## KRIMET E RENDA: RASTI "XHAFAJ", ERVIN SALIANJI DYSHOHET PER KALLEZIM TE RREME

# PROKURORIA: "BABALJA", DEPUTETI I PD NEN HETIM

Dosja/ Fredi Alizoti ishte në përgjim, pranoi se luajti 'rolin' e Agron Xhafajt. Rama: Fabrikim dëshmitarësh. Basha: Komplot për manipulimin e së vërtetës



(Në foto) Fredi Alizoti, Deputeti i PD, Ervin Sallianji

Në faqen 2-3

VENDIMI I GJYKATES

Masakra me tre të vrarë bulevard, burg përjetë për 'killerin' e Kamorras  
Në faqen 7

"FORCA E LIGJIT"

Pranga Ilir Boriçit në Fier, policia i gjen dy armë dhe shpatë në shtëpi  
Në faqen 8

PAS KRIMIT NE BLOK

Nuk zbatoi urdhrin për Ervis Martinajn, shkarkohet drejtori i Policisë së Burgjeve  
Në faqen 6

FLET VELINA

Alesia Bami: E vështirë të jesh VIP, s'blen dot as bukën pa bërë grim  
Në faqen 14

DOKUMENTET/ NGA DASHNOR KALOÇI



Ramizi: Libri i

Petro Markos të bëhet karton, asnjë kopje në qarkullim  
Në faqen 16-17

Zbardhet vendimi/ Vjetërsia në punë, 2% më shumë nga masa e përcaktuar

## Rritje pagash në mjekësi, kush përfiton

Zbardhen ndryshimet, shtesë rroge edhe për kategorinë e infermierëve

Nga VOLTIZA DURO

Mjekët, infermierët dhe punonjësit me arsim të lartë që janë pjesë e sistemit të shëndetësive do të përfitojnë rritje page. Vendimi është marrë nga Këshilli i Ministrave dhe ka hyrë në fuqi menjëherë pas botimit në Fletoren Zyrtare.



"Gazeta Shqiptare" zbardh sot vendimin e qeverisë dhe rritjet e pagave për secilën kategori përfituese që është pjesë e sistemit shëndetësor në vend. Kështu, shtesa në pagesë për vjetërsi pune do të ketë një vlerë 2% më të lartë krahasuar me vitin e kaluar ...  
Në faqen 10

# "BABALJA" AUDIOPËRGJIMI

Prokuroria e Krimeve të Rënda reagon për videon e publikuar nga deputeti i PD

## 'Babalja', Krimet e Rënda: Salianji nën hetim për "kallëzim të rremë"

### Deputeti demokrat thirret për të dëshmuar në 12 tetor

**P**rokuroria e Krimeve të Rënda ka reaguar lidhur me videon e publikuar nga deputeti i Partisë Demokratike Ervin Salianji. Prokuroria tha se Fredi Alizoti është shoqëruar me urdhër të prokurorisë dhe shoqërimi është bërë nga policia e Fierit.

#### DEKLARATA E PLOTË:

Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda, është duke zhvilluar hetime në kuadër të procedimit penal Nr. 95/v.2018 për veprën penale të "Trafikimit të narkotikëve", parashikuar nga neni 283/a i Kodit Penal. Më datë 05.10.2018, lidhur me autenticitetin e regjistrimit të bisedës së pretenduar të jetë kryer midis shtetasve Albert Veliu dhe Geron Xhafaj u është regjistruar emri si persona nën hetim shtetasve Albert Veliu, Fredi Alizoti, Jetmir Olldashi dhe Ervin Salianji për veprën penale të "Kallëzimit të rremë" të kryer në bashkëpunim, të parashikuar nga neni 305 e 25 i K.Penal, ndërsa për shtetasin Albert Veliu dhe për veprën penale të "Kalimit të Paligjshëm të Kufirit" të parashikuar nga neni 297 i Kodit Penal.

Nisur nga lajmet dhe njoftimet e bëra publike në media gjimë me vend të sqarojmë opinionin publik për disa nga momentet kryesore që po debatohen në lidhje me këtë çështje dhe konkretisht:

1-Nga hetimet në kuadër të procedimit penal krahas veprimeve të tjera hetimore, më datë 01.06.2018 i janë marrë deklaratime shtetasit Fredi Elmaz Alizoti me cilësinë e personit që ka dënuar për rrethanat e hetimit. Ky shtetas është shoqëruar në Prokurorinë Pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda nga Drejtues të Drejtorisë Vendore të Policisë Fier pas komunikimit me sallën operative të kësaj Drejtorie po në këtë datë. Nga Drejtues të Policisë Fier është komunikuar me prokurorin e çështjes ku është vënë në dijenjë për bisedën telefonike të bërë dhe, nga ana e prokurorit të çështjes u është kërkuar drejtuesve të policisë Fier, shoqërimi i këtij shtetasi për në Prokurorinë e Krimeve të Rënda. Shtetasi Fredi Alizoti ka qenë në përgjim për nevojat e hetimeve, me Vendimin e Prokurorit të datës 22.05.2018, të vlefshëm me vendimin e Gjykatës Nr. 457 datë 24.05.2018, pra disa ditë para se të komunikonte me sallën operative të policisë Fier dhe të pyetej nga prokuroria. Kjo për shkak se gjatë përgjimit të bisedave telefonike të shtetasit Albert Veliu ka rezultuar si personi që ka komunikuar me të disa herë i shqetësuar duke bërë biseda, për të cilat ka patur të dhëna gjatë përgjimit për përfshirjen e tij bashkë me shtetasin Albert Veliu në realizimin e audio përgjimit. I pyetur në datë 01.06.2018, ky shtetas ka deklaruar që rreth orës 16.00, të datës 01.06.2018, kishte kërkuar të komunikonte me



#### VIDEO E SALIANJIT

Deputeti demokrat ndau edhe me ndjekësit në "FB" videon e publikuar më parë në "Opinion", ndërsa shkroi se në video është dëshmitari i prokurorisë mbi dëshminë dhe përgjimet e të cilit kanë marrë masë shtrënguese mbi një gazetar që i ka shërbyer publikut me investigim me risk të lartë. Në video, Fredi Alizoti deklaronte se ishte marrë me makinë nga drejtori i përgjithshëm i Policisë, Ardi Veliu dhe ishte çuar në Prokurorinë e Krimeve të Rënda, në mënyrë që të pranonte versionin që i shkon për shtat mazhorancës.

## U tha se shoqëroi Alizotin, reagon Ardi Veliu: Fund e krye e pavërtetë

**P**olicia e Shtetit ka reaguar pas shfaqjes së videos mbrëmjen e kaluar ku Fredi Alizoti, personi që sipas Prokurorisë ka imituar zërin e Agron Xhafajt në audio-përgjim deklaronte se ishte shoqëruar nga drejtori i Përgjithshëm i Policisë Ardi Veliu për në Prokurori. Policia e Shtetit mohon se Veliu ka kontaktuar apo është shoqëruar me personin në fjalë duke e quajtur videon fund e krye të pavërtetë. Për më tepër policia deklaroi se mund të verifikohet lehtë se Drejtori i Përgjithshëm në ditën që shtetasi Alizoti është shoqëruar në Prokurorinë e Krimeve të Rënda, ka qenë



me angazhime të tjera. "Drejtori i Përgjithshëm i Policisë së Shtetit nuk ka qenë për asnjë rast, në asnjë rrethanë dhe në asnjë cilësi shoqëruar, kontaktues apo në çdo formë tjetër i shtetasit Alfred Alizoti. Atë që ky i fundit deklaroi në një video të regjistruar në mënyrë

të fshehtë dhe e prezantuar publikisht nga deputeti Salianji, është fund e krye e pavërtetë", thuhet në reagimin e Policisë së Shtetit. Sipas policisë, Veliu atë ditë ka qenë me angazhime të tjera. "Me përgjegjësi publike deklarimë se Drejtori i Përgjithshëm i Policisë së Shtetit në asnjë rast nuk është përfshirë në veprime procedurale në lidhje me hetimin e çështjes të ashtu njohur publikisht si çështja "Babalë". Edhe nëse kjo mund të kishte ndodhur, ajo nuk do të përbente asnjë shkelje ligjore për sa kohë do të ishte në zbatim të urdhërimeve të prokurorisë, ose gjykatës", thuhet në deklaratën e policisë.

dhe është ftuar të caktojë një mbrojtës. Deklaruesi ka kërkuar të japë shpjegime pa praninë e mbrojtësit duke theksuar se u qëndronte deklaratimeve, por më të detajuara do t'i jepte një ditë tjetër: I janë marrë dhe modele zëri këtij shtetasi në prani të ekspertit kriminalist. Është këqyruar dhe libri i njoftimeve të Sallës Operative të Drejtorisë Vendore të Policisë Fier, ku provohet komunikimi që ka patur ky shtetas me specialistin e Sallës Operative.

2-Është vendosur kryerja e ekspertimit teknik, duke caktuar si ekspert, ekspertët britanikë të kompanisë JP

#### Padia për shpifje ndaj Bashës,

#### Balla: Do i shkojë deri në fund

**N**isi dje, në Gjykatën e Tiranës gjyqi mes kreut të Grupit Parlamentar të Partisë Socialiste Taulant Balla dhe kryetarit të Partisë Demokratike Lulzim Basha. Balla deklaroi në një prononcim pas seancës së parë se do i shkojë deri në fund procesit. Ai u shpreh i bindur se gjykata do i japë të drejtë. Ai ka paditur Bashën për shpifje si dhe nxjerrje të sekretit hetimor për çështjen e 3.4 milionë eurove të gjetura në dy makinat "Toyota Yaris" në Portin e Durrësit. Kreu i PD-së u përfaqësua në gjyq nga avokati Gazmend Bardhi dhe Ivi Kaso ndërsa socialisti Balla ka zgjedhur të jetë edhe vetë bashkë me avokatit. Kreu i PD akuzoi Ballën si garant i 3.4 mln eurove të sekuestruara, para këto sipas liderit të PD-së të destinuar për një nga klanet e drogës në Elbasan.

French Associates. Fillimisht jemi drejtuar Ambasadës Britanike, oficerëve të kontaktit të NCA pranë kësaj ambasade për asistencë në kryerjen e një ekspertimi zëri. Nga informacioni zyrtar që na është vënë në dispozicion rezultoi se në Mbretërinë e Bashkuar nuk ka institucion shtetëror për kryerjen e një ekspertimi të tillë, dhe se kompania e sipërcituar është kompania kontraktuar nga vetë autoritetet shtetërore britanike për kryerjen e ekspertimeve në vend. Për këtë arsye nga ana jonë është dërguar materiali për ekspertim pranë kësaj kompanie.



3-Nga ana e Prokurorisë së Krimeve të Rënda nuk është administruar asnjë akt ekspertimi i kryer nga laboratorët shkencorë të Policisë në Itali, për shkak se autoritetet italiane kanë refuzuar ekspertimin për shkak procedurale që lidhen me aplikimin e Konventës për Ndhimë të Ndërsjellët në Fushën Juridike Penale, dhe se kryerja e këtij veprimi nuk lidhet me territorin e shtetit italian.

4-Lidhur me materialin e dërguar për ekspertim sqarojmë se objekt ekspertimi është DVD-ja e sekuestruar në Partinë Demokratike nga deputeti Enkelejd Alibeaj si përfaqësues i kësaj force politike.

5-Modele eksperimentale janë dërguar mostra të zërave të shtetasve Geron Xhafaj, Albert Veliu, Fredi Alizoti dhe Agron Hyseni të marrë konform rregullave procedurale.

6-Shtetasi Jetmir Olldashi nuk ka dorëzuar në asnjë moment materialin original si dhe mjetet, me të cilat është pretenduar se është realizuar audio-përgjimi që lidhet me bisedën e pretenduar të zhvilluar midis shtetasve Albert Veliu dhe Geron Xhafaj duke pretenduar se nuk e disponon dhe kopje të tij ia ka dorëzuar shtetasit Ervin Salianji.

7-Provat e sipërcituar janë paraqitur përpara Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda Tiranë, e cila me Vendimin nr 142 datë 06.10.2018 ka caktuar masat e sigurimit "arrest me burg" për shtetasit Albert Veliu dhe Fredi Alizoti dhe "Detymir për t'u paraqitur në policinë gjyqësore" për shtetasin Jetmir Olldashi.

Më datë 12.10.2018 i është bërë ftesë për paraqitje shtetasit Ervin Salianji për t'u pyetur si person, ndaj të cilit zhvillohen hetime për veprën penale të "Kallëzimit të rremë" në bashkëpunim me personat e sipërcituar. Sa më sipër ju bëjmë me dije se ky është qëndrimi zyrtar i Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda referuar të dhënave që kanë rezultuar nga hetimet deri në këto momente.





Kreu i PD: Kryeministri krijoi grup të posaçëm për mbrojtjen e familjes Xhafaj

# "Babalja", Rama: Si i bëhet të vërtetës? Basha: Do japësh llogari

"S"do rrijë pa mbuluar pjesa që dimë të dy"

Valentina Madani

Kreu i opozitës, Lulzim Basha akuzoi dje se kryeministri Rama "ka krijuar një grup të posaçëm për të mbrojtur familjen e ministrit Xhafaj, duke falsifikuar prova dhe dëshmitarë". Basha foli për një komplot institucional mes kryeministrit, kryeprokurores dhe ministrit të Brendshëm për të manipuluar të vërtetën. Kamera e fshehtë e publikuar në "Opinion", ku i arrestuari për çështjen "Babalë", Alfred Alizoti implikon drejtorin e përgjithshëm të Policisë dhe deputetin Taulant Balla, për Lulzim Bashën është dëshmi e krijimit të një shteti privat, përmes së cilit ai shprehet se Edi Rama po fabrikon dëshmitarë për të shpëtuar vëllain e ministrit të Brendshëm, Agron Xhafaj. "Mbrëmë shqiptarët panë fytyrën e këtij shteti privat, deputet, drejtor policie dhe prokuror që fabrikonë prova dhe dëshmitarë për të shpëtuar kriminelët. Drejtues të kësaj strukture janë edhe Xhafaj me Arta Markun. Rama, Xhafaj, Balla, Arta Marku, Ardi Veliu kanë komplotuar për të manipuluar të vërtetën dhe për të mbrojtur një trafikant droge, Agron Xhafaj. Shteti i Ramës vendosi që të fabrikonte dëshmitarë me një qëllim, për të shpëtuar Agron Xhafajin", deklaroi z.Basha. Kreu i opozitës flet për një diktaturë mafioze, në shërbim të së cilës sipas tij është vëllai edhe prokuroria. "Drejtesia është kthyer në një drejtësi kriminale. Arta Marku nuk do të nisë kurrë hetimet për Taulant Ballën", u shpreh kreu i PD-së. Për të gjithë kundërshtarët e tij politikë, të cilët i akuzon se janë rreshtuar në krah të kriminit pati një paralajmërim. "Edi Rama, Taulant Balla, Fatmir Xhafaj, Arta Marku, Ardi Veliu e shërbëtorët e tyre do të dalin para drejtësisë, sikur të gjithë kriminelët e tjerë. Drejtësia ndaj tyre nuk do të mungojë, rruga e pandëshkueshmërisë do të marrë fund bashkë me pushtetin e tyre", tha z.Basha. Më pas, kreu i PD publikoi një video në "Facebook", në të cilën shprehet se Rama krijoi grup të posaçëm për të mbrojtur familjen kriminale të



**LULZIM BASHA**  
"Shteti sulmon gazetarët, denoncuesit, policët e ndershëm, kundërshtarët politikë për të mbrojtur kriminelët dhe politikanët e lidhur me krimin. Jemi në kushtet e një diktature mafioze. Kanë komplotuar për të mbrojtur një trafikant droge si Agron Xhafaj. Rruga e pandëshkueshmërisë do të marrë fund bashkë me pushtetin e tyre".

**EDI RAMA**  
"Po artist po, këtë aktorin mund ta gënjenit dy herë, edhe kur e futët në rrugën e burgut me filmin, edhe kur i thatë jepi, shpif për Taulantin që të shpëtosh nga burgu! Po si i bëhet të vërtetës o artist, të vërtetës që s'ka mbushës e analist kazani që e mbulon dot? E di, në hall je", tha kryeministri Edi Rama.

## Ndreu: Hajde të bëjmë vetingun

### Berisha publikon foton: Deputeti i PS-së vdes për trafikantët

Ish-kryeministri Sali Berisha publikoi dje një mesazh të një qytetari që thotë se deputeti i PS-së, Pjerin Ndreu, i siguron mbrojtje një trafikanti, i cili bën ligjin me emërimet në Pushë-Arrëz e Pukë. Berisha shkruan se "Pjerini vdes për trafikantët". Ata kanë para shumë! Lexoni mesazhin e qytetarit dixhital. Bashkëngjitur po ju informoj mbi kriminalitetin që ndodh në Pushë-Arrëz-Pukë, në foto, në krahun e majtë të Z.Pjerin Ndreu, Albert Tuci vëllai i kryetarit të bashkisë, z. Fran Tuci. I dënuar për trafik dhe vazhdon i qetë punën, pasi siç shihet në foto, ka mbrojtjen e vëllait dhe të deputetit Ndreu. Gjithashtu, çdo emërim në punë bëhet me urdhrin e tij", thuhet në mesazhin drej-



por edhe Beogradi. Ndreu i kujton Berishës së është malësor dhe thotë se në shtëpinë e tjetrit nuk i zgjedh të ftuarit, duke justifikuar kështu foton me ish-të dënuarin për trafik droge. "Doktor, hajde bëjmë ceting për dërgat, por kam frikë se do habitet edhe Prishtina, jo vetëm Tropoja me dërgat e tua, se Beogradi ti dhe unë e dimë që nuk habitemi, se ka edhe biseadit që ke bërë me ata, jo vetëm fotografi! Hiq dorë nga përndjekjet e njerëzve me dreka e dërgat se ato janë pa protokoll, nuk kanë kriter dëshminë e penaltetit! Meqë je edhe malësor, por që ke harru rregullat elementare të tavolinës, në shpi të tjetrit nuk i vendos rregullat e as nuk zgjedh të ftuarit ti!", shprehet z.Ndreu.

tuar z.Berisha. Por, deputeti socialist, Pjerin Ndreu reagoi pas publikimit të fotos së tij me një personazh ish-të dënuar nga ish-kryeministri Sali Berisha. Në një status në "Facebook", Pjerin Ndreu e fton Berishën të bëjnë veting për dërgat, duke i përmendur dërgat e tij, për të cilat thotë se do habitet jo vetëm Tropoja,

ministrit të Brendshëm, Fatmir Xhafaj. "Grupi i posaçëm që ka krijuar Edi Rama për të mbrojtur familjen kriminale Xhafaj, duke falsifikuar prova e dëshmitarë dhe sulmuar këdo që rrezikon kriminelët", - tha Basha. Akuzave të kryetarit të PD, Lulzim Basha, se ka Rama krijuar një "shtet privat" të asgjësuar provat në çështjet e Agron Xhafajit dhe

Xhisiela Malokut, kryeministri iu përgjig nga rrjetet sociale. "E di artist, keq puna! Po ç'nga sikleti se u kape me prasin në dorë këtë herë e ca nga vesi që del me shpirtin dhe ty as nuk të rrihet pa vazhduar të sajosh e të gënjesht. E di o xhan që ti edhe veten e gënjen si askush, por mos shpreso kot se do rri mbuluar ajo pjesa që dimë të dy". Më tej, kryeministri pyet

Bashën se çfarë ka me Xhisiela Malokun që s'e lë rehat. "Ah dhe diçka me rëndësi: Po me vazhden çfarë drejtin ke që s'e lehat? Ajo peng i kriminit? Pengu juaj po, pa diskutim! Lëshojni vazhën e bëhuni njëherë të vetme burra dhe përballuni me shpifin tuaj! Ik merri kamerat e komisariatit e shikojni bashkë me lehaqeniet e kanzanit tënd".



**Paloka, Ramës:**  
Rinxore "Babalen" për t'i shpëtuar "Xhisielës", të plasën ujërat

Kreu i grupit parlamentar të PD-së, Edi Paloka, sulmoi dje kryeministrin Edi Rama teksa u shpreh me ironi se ndërsa ai dhe prokuroria do t'i shkonin deri në fund "Babales", "i plasën ujërat". Po ashtu, demokrati tha se Rama rinxori "Babalen" për t'i shpëtuar "Xhisielës", ndërsa tani iu rikthye "Xhisielës" për t'i shpëtuar "Babales". "Për të shpëtuar nga 'Xhisiela' pak ditë më parë, nxore prapë në skenë 'Babalen'. I bindur që 'struktura e posaçme' që kishe ngarkuar privatisht t'i kishte kopsitur gjërat. Dje deklaroi me tërsëllimë se ti bashkë me prokurorinë, do i shkoni deri në fund 'Babales'. Po në darke të plasën ujërat! Të plasi në dorë skema që mendoje se e kishe përgatitur si lojtar i madh bashkë me 'strukturën e posaçme', shprehet z.Paloka.



**"Babalja", Alibeaj:**  
Veliu dhe Balla i bënë presion Alizotit

Deputeti i PD, Enkelejd Alibeaj deklaroi dje se përfaqësuesit e shtetit janë të zhytur në krim. I ftuar në rubrikën "Opinion", Alibeaj komentoi versionet e kuzatit të Albert Velikut, Fredi Alizoti në lidhje me çështjen e audio përgjimit që pretendohet se shfaqet vëllai i ministrit Fatmir Xhafaj në trafik droge. "Përfaqësues të shtetit janë zhytur në krim. Pra, ka dy versione të Fredi Alizotit në këtë histori. Besoni Alizotin nën presion policor apo të qetë në një tavolinë kafeneje? Historia nuk fillon tek Alizoti, por nis kur doli video përgjimi i Albert Velikut që tregoi trafikun e drogës të vëllait të ministrit Xhafaj. Xhafaj duhet t'i nënshtrohej ligjit anti-mafia. Alternativa tjetër është të shkatërronte sistemin dhe të krijonte alibi. Qeveria krijon alibi përmes Prokurorisë. Arta Marku është celulë kriminale e PS. Ekspertiza britanike ka thënë se zëri është i ngjashëm me atë të Agron Xhafajit. Ata e kanë çuar materialin për ekspertizë me cilësi të dobët", - tha Alibeaj.

# INTEGRIMI KUSHTET

Valentina Madani

Shqipërisë i duhen rezeultate konkrete në procesin e vettingut si dhe në betejën kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar për të bindur vendet skeptike në dhënien e votës pro hapjes së negociatave të integritimit të Shqipërisë. Drejtori i Zgjerimit në KE, Danielsson i kujton politikës shqiptare se dera është e hapur, por për këtë duhen hapa të qartë. Për ministrin Bushati, rëndësi të madhe ka procesi i "screening". Ndërsa presidenti Meta kërkon dialog për realizimin e reformave. Vendet e Bashkimit Evropian do të japin votën pro Shqipërisë në qershor nëse do të realizohet reforma në drejtësi dhe do të ketë rezultate konkrete në luftën ndaj korrupsionit. Gjatë seminarit për impaktin e negociatave në administratë, drejtori i Përgjithshëm për Zgjerimin në Komisionin Evropian, Christian Danielsson, i kujtoi politikës shqiptare se dera e BE është e hapur, por vetëm në këtë mënyrë do të binden vendet skeptike. "Mund t'i bindni vendet skeptike të Unionit duke vijuar me procesin e vettingut si dhe duke dhënë rezultate konkrete kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar", theksoi z. Danielsson.

Negotiatat, Meta: Dialog për 5 prioritetet. Bushati: Me rëndësi, procesi i "screening"

## Negotiatat pas vettingut, KE: Bindemi, nëse bëni reformën në drejtësi

Danielsson: Luftoni krimin dhe korrupsionin



**DEKLARATA**  
Drejtori i Përgjithshëm në KE, Christian Danielsson, tha se ka ardhur koha që Shqipëria të ndërmarrë vendime strategjike, të cilat do të kenë ndikim në gatishmërinë e saj për negociatat e ardhshme. "Mund t'i bindni vendet skeptike të Unionit duke vijuar me procesin e vettingut si dhe duke dhënë rezultate konkrete kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar", theksoi z. Danielsson.



Parlamenti European

### "Raporti, sinjal i rëndësishëm për Shqipërinë"

PE, Fleckenstein: Të funksionojë Gjykata e Lartë dhe Kushtetuesja

Raportuesi për Shqipërinë, Knut Fleckenstein përshëndeti dje miratimin e raportit në Komitetin e Jashtëm të PE-së. Ai shprehet se ky është një sinjal i rëndësishëm për shqiptarët që të vazhdojnë me reformat, në mënyrë që në qershor të hapen negociatat. "Raporti im i Shqipërisë u votua në komitetin e jashtëm të Parlamentit Evropian. Jam shumë i kënaqur që raporti u miratua nga një shumicë dërrmuese. Sinjal i rëndësishëm për partnerët tanë shqiptarë, këshillin dhe komisionin që të vazhdojnë reformat me sukses, të fillojnë negociatat 2019-ën", deklaroi z. Fleckenstein. Nëse 2 gjykatat më të rëndësishme në Shqipëri, ajo Kushtetuese dhe Gjykata e Lartë nuk funksionojnë, për komisionerin Knut Fleckenstein lufta kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar nuk mund të kenë sukses. "Sepse nëse këto organe nuk funksionojnë, të gjitha objektivat e tjera do të jenë shumë më të vështira për t'u arritur. Unë do thosha sërish që diferencën do ta bëjë së pari zbatimi i reformës në drejtësi, pasi nëse ky sistem nuk funksionon normalisht, atëherë është e pamundur të arrihet sukses në luftën kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar. Pra, ky është një kriter shumë i rëndësishëm, por nuk bëhet fjalë për përzgjedhje midis kriteve, pasi nuk do gjykojmë vetëm ministrat e Drejtësisë për përparimin e Shqipërisë, por edhe ata të Punëve të Brendshme". Raporti është fokusuar edhe tek ecuria që duhet të ketë Shqipëria në aspektin social dhe atë financiar.

**Shehu në Asamblenë e KiE: Familja, e lidhur me ekzistencën tonë**

Drejtuesi i PD, Tritan Shehu, mbajti një fjalë në Asamblenë të Komitetit Evropian të Kështjës dhe Kështjës, në kuadër të një rezolute për familjen. Shehu në fjalën e tij ka theksuar se familja mbetet e shenjtë dhe deklaroi se është kundër një shoqërie diskriminuese. "Por nga ana tjetër, unë nuk pajtohem me shumë interpretime dhe konkluzione të rezolutës, të cilat nuk janë në përputhje me vlerat tona universale, vlerat ndaj familjes, që mbetet shtylla e shoqërisë sonë. Familja është e shenjtë, koncepti i saj i përbërës nga një burrë, një grua dhe me shpresën në Zot që në të ardhmen të kenë edhe fëmijë nuk mund të ndryshojë me ligje apo vendime", ka deklaruar ndër të tjera Shehu gjatë fjalës së tij.

**TAKIMI**  
Kreu i PD, Lulzim Basha, takoi dje ambasadorin e BE-së në Shqipëri, Luigi Soreca. Në fokus të takimit të kryetarit të opozitës me ambasadorin Soreca mësohet se ka qenë reforma zgjedhore dhe situata kriminale në vend. Ky është takimi i parë i Soreca me Bashën që kur mori detyrën si ambasador i BE-së në Shqipëri.



Vetingu, PD kërkon mbështetje në PPE

### Tabaku në Vjenë: Ligjin e bëjnë oligarkët dhe të fortët

Lidhja e politikës me krimin, korrupsionin në tendera, konkacione e PPP, mungesa prej gjashtë muajsh e Gjykatës Kushtetuese, protesta prej pesë muajsh e artistëve kundër ligjit që i hap rrugë prishjes së paligjshme të Teatrit Kombëtar dhe ndërimit të kullave për afëra klienteliste" u diskutuan nga deputetja Jorida Tabaku në Akademinë Politike të Vjenës, në të cilën ishte i pranishëm edhe deputeti Oerd Bylykbashi. Deputetja Tabaku i kërkoi mbështetje PPE-së për vettingun e politikës, pasi gjendja aktuale e demokracisë, institucioneve si dhe ndarjes së pushteteve është në rrezik. "PD ka ndërmarrë nismën e ndarjes së politikës nga krimi. Vetingu në politikë është një proces jetik për Shqipërinë dhe të ardhmen e saj europiane. Ndihma e PPE dhe partive simotra në këtë proces është shumë i mirëpritur jo vetëm për rëndësinë e kauzës, por pasi krimi me mbështetje qeveritare është edhe një kërcënim për BE-në. Propozimi i dytë ka të bëjë me Platformën Antikorruption dhe Oligarkit, që synon sekuestrimin e pasurive të përfutuara në mënyrë korruptive nga kompanitë e lidhura me qeverinë dhe mazhorancën. Pasuri të përfutuara nga tenderat, konkacionet dhe formati PPP, i aplikuar në mënyrë antikushtetuese nga qeveria për të favorizuar një dorë biznesesh", tha Tabaku. Sipas saj, PD e ka integrimin evropian një qëllim jetik, ndaj ka vendosur të bëjë gjithçka në këtë drejtim, teksa qeveria me treguesit e saj negativë po e largojnë Shqipërinë nga BE. Diskutimet u shtruan në takimin vjetor të organizuar nga Partia Popullore Europiane (PPE) dhe Fondacioni Konrad Adenauer (KAS) në Akademinë Politike në Vjenë.

vendimin e ardhshëm për çeljen e negociatave të anëtarësimit me Bashkimin Evropian. Duke ndarë vlerësimin e shprehur edhe në projektrezolutën e miratuar dje në Komisionin e Jashtëm të Parlamentit Evropian, kreu i shtetit vuri në dukje se nevojiten përpjekje të shumëfishuara dhe trajtim përparësor i sfidave madhore, të cilat kanë ndikim të drejtpërdrejtë edhe në ekonominë e vendit. Kreu i shtetit bëri thirrje që të gjitha palët, sipas përgjegjësisë institucionale që mbajnë, të angazhohen në një dialog të institucionalizuar dhe

strukturuar për t'u dhënë zgjidhje çështjeve tashmë emergjente që lidhen me shtetin ligjor dhe të së drejtës. Z. Danielsson u prit edhe nga kryetarja e LSI-së, Monika Kryemadhi, ku në qendër të diskutimeve ishte integrimi i vendit dhe angazhimi i opozitës në këtë proces.





Darina Tanushi

Kryeministri, thirrje medias: Hiqni reklamat e basteve, e paligjshme!

# Mbyllja e kazinove, nga 1 janari 9 mijë të papunë, Rama nxjerr vendimin

*Pezullohet Autoriteti i Mbikëqyrjes së Lojërave të Fatit*

Qeveria publikoi dje ndryshimet në ligjin për lojërat e fatit, sipas të cilit nga 1 janari 2019 nuk do të ketë më pika bastesh apo kazino në qendrat e banuara. Në projektligjin e ri është vendosur gjithashtu që për bastet sportive dhe bastet për garat në pistë të ndërpriten dhënia e licencave të reja. Qeveria ka vendosur edhe pezullimin e përkohshëm të aktivitetit të Autoritetit Mbikëqyrës të Lojërave të Fatit deri në ristrukturimin e këtij institucioni, duke ia kaluar kompetencat përgjatë kësaj periudhe ministrit të Financave, Arben Ahmetaj. Sipas të dhënave zyrtare, aktualisht në të gjithë vendin numërohen rreth 4.500 pika bastesh. Në reagimin e tij dje, bashkë me publikimin e projektligjit që do t'i dërgohet Kuvendit, kryeministri Rama u shpreh se vendimi është përcjellë për miratim në parlament, ndërsa sipas tij, në 31 dhjetor do të mbyllet të gjitha qepenat. "Ligji për ndalimin e basteve e kazinove elektronike u nis në parlament. Në 31 dhjetor mbyllet përfundimisht të gjitha qepenat", shkroi dje Rama ndërsa ka postuar edhe projektligjin e miratuar nga Këshilli i Ministrave. Po ashtu, kryeministri u bëri thirrje të gjitha portaleve apo televizioneve që të hiqnin reklamat e basteve. "Bastet e kazinotë elektronike do të dalin jashtë ligjit në 31 dhjetor. Ama çdo reklamim i tyre në çdo lloj media është i jashtëligjshëm. Portalet që kanë ende reklama të tilla t'i heqin vetë se ndërkohë po punohet për mbylljen e tyre! Më mos kemi ilafë për lirinë e shtypit pastaj", u shpreh dje kryeministri.

**VENDIMI**  
Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të ligjit nr.9000, datë 30.1.2003. "Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave" dhe të ligjit nr.90/2012 "Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore", me propozimin të ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave



Faksimile e projektligjit për lojërat e fatit

**SHIFRAT**  
Sipas të dhënave zyrtare, aktualisht në Shqipëri ka rreth 4.500 pika bastesh, të cilat sipas Kodit të Punës duhet të punësojnë minimalisht nga dy veta. Pra, në total janë minimalisht 9.000 të punësuar, të cilët nga 1 janari do të dalin të papunë.

## Kryeministri, qytetarëve: Denonconi drejtorët e korruptuar që marrin para

Kryeministri i vendit, Edi Rama u bëri thirrje dje qytetarëve që t'i drejtohen platformës së bashkëqeverisjes për të shkarkuar të gjithë ata drejtorë të korruptuar shkollash që kërkojnë para në këmbim të një vendi pune. "Kemi drejtues shkollash të shkëlqyer, por edhe të korruptuar e të paafit që mund t'i identifikojmë së bashku. Janë një pjesë që duhen larguar një orë e më parë nga drejtimi i shkollave", u shpreh dje Rama. Disa raste u bënë publike gjatë takimit javor me koordinatorët e bashkëqeverisjes. Një prej tyre ishte Abaz Kojnozi, të cilit nuk i ishin njohur 11 vite sigurime, kur punonte si agronom.

"11 vite punë nuk mu njohën nga sigurimet shoqërore. Isha i detyruar, kisha shumë besim tek qeveria. Më kthyen përgjigje shumë shpejt jam shumë i kënaqur, këtu shihet që ato që qeveria thotë bëhen realitet", u shpreh qytetari. Sipas Ramës, platforma është e vëmtejshme që kanë qytetarët e thjeshtë për të gjetur mikun që të ndërhyjnë direkt tek ministri. "Platforma të gjen mikun edhe sikur të jesh në fund të botës, në pikën ku ke mbetur vetëm dhe askush nuk të kthen sytë, jo mik dosido por mik direkt ministrin, titullarin më të lartë të institucionit përmes grave, burrave që punojnë për platformën, që janë më të pakortueshmit", tha Rama.

**VENDOSI**  
1. Pezullimin e përkohshëm të veprimtarisë, në fushën e lojërave të fatit, të Autoritetit të Mbikëqyrjes së Lojërave të Fatit (AMLF), deri në ristrukturimin e këtij institucioni.  
2. Ngarkohet ministri i Financave dhe Ekonomisë, si organi epor, të nxjerrë aktet e nevojshme për ristrukturimin e AMLF-së, si dhe të ndjekë zbatimin e

këtij procesi.  
3. Ngarkohet ministri i Financave dhe Ekonomisë të përcaktojë aktivitetet konkrete që do të vijojë të kryejë AMLF-ja, për mbikëqyrjen e veprimtarisë së lojërave të fatit, gjatë periudhës së përkohshme të pezullimit.  
4. Ngarkohen Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe Autoriteti i Mbikëqyrjes së Lojërave të Fatit për zbatimin e këtij vendimi. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

Në nenin 71 të dispozitave kalimtare të këtij ligji vendoset përcaktimi: Organizatorët e kategorive "Baste sportive" dhe "Baste për garat në pistë" do të ushtrjnë aktivitetin e tyre deri në datën 31 dhjetor 2018. Të gjitha aplikimet për pajisjen me licencë për kategoritë e sipërpërmendura, në proces shqyrtimi, ndërpriten.

## PASOJAT E MBYLLJES

Sipas deklarimeve zyrtare në Tatime, vitin e kaluar industria e kumarit qarkulloi rreth 130 milionë euro, ku pjesën e "luanit" e kanë kazinotë. Sipas të dhënave zyrtare, vitin e kaluar shqiptarët luajtën 81 milionë euro në kazino dhe 45.5 milionë euro të tjera në baste sportive. Vendimi i qeverisë pritet t'i reduktojë ndjeshëm të dy këto aktivitete, por veçanërisht bastet, të cilat nga 1 janari do të lejohen vetëm "online". Në rrafshin ekonomik, kufizimi i kumarit ka dy pasoja kryesore. E para është rënia e të ardhurave në buxhet. Aktualisht, qeveria mbledh rreth 40 milionë euro në vit nga taksat e bixhozit. Pas 1 janarit, kjo shumë më gjasa do të jetë më e vogël, gjithsesi për buxhetin ky është një efekt i papërfillshëm. Pajoja e dytë është punësimi. Sipas të dhënave zyrtare, aktualisht në Shqipëri ka rreth 4.500 pika bastesh, të cilat sipas Kodit të Punës duhet të punësojnë minimalisht nga dy vetë. Pra, në total janë minimalisht 9.000 të punësuar, të cilët nga 1 janari do të dalin të papunë. Por, të dy këto efekte, si rënia e taksave, ashtu dhe punësimi, duken të papërfillshme përballë pasojave të rënda sociale që vijnë nga bixhozi dhe risqeve që ka kjo industri për pastrim parash dhe fuqizim të krimit, citon "TCH".

## DEKLARATA

"Nga diskutimi për Paketën Antishpifje del qartë se urbanizimi i xhunglës online nis nga legalizimi i portaleve. Legalizimi mund të bëhet në pak minuta përmes regjistrimit online në QKB. Duke qenë se janë fantazma pa adresë e pa emër,uroj ta lexojnë këtë mesazh para ditës së hënë", shkroi dje, kryeministri Rama.



## Lojërat e fatit, krerët e bashkësive fetare: Të ruajmë të rinjtë nga veset

Bashkësitë fetare kanë reaguar pas vendimit të qeverisë për heqjen e të gjitha reklamave mbi lojërat e fatit, nga mediat dhe portalet si dhe të kazinove nga qendra e banuara. Përmes një njoftimi, Kryegjyshata Botërore Bektashiane ka mirëpritur me optimizim iniciativën e qeverisë që sipas këtij komuniteti fetar ruan rininë dhe familjen larg veseve. "U njoftuam nga mediat mbi iniciativën e fundit qeveritare lidhur me lojërat e fatit. Në këtë rast e shikojmë me optimizim nismën, e cila u bashkohet vlerave të bektashinjeve, për të ruajtur rininë dhe familjen tonë të pastër, larg veseve. Le të shpërojmë që nisim të tilla në dobi të shoqërisë të shtohet", - thuhet nga Kryegjyshata Botërore Bektashiane. Ndërkohë në lidhje me këtë iniciativë të qeverisë ka reaguar edhe Komuniteti Mysliman i Shqipërisë që ka mirëpritur vendimin. "Komuniteti Mysliman i Shqipërisë ka mirëpritur vendimin e qeverisë për mbylljen e kazinove elektronike dhe basteve sportive në zonat e banuara. Ky është një vendim i mirëpritur dhe i gëzueshëm për të gjithë qytetarët shqiptarë dhe një masë e rëndësishme në mbrojtjen e të rinjve nga rënia në kthetrat e këtyre veseve që sjellin dëme të pariparueshme në familje dhe në shoqëri", - thuhet në reagimin e KMSH.

## VRASJA NE BLOK PASOJAT

Drejtori i përgjithshëm nuk zbatoi vendimin e gjykatës për të plagosurin Ervis Martinaj

# Shkarkohet kreu i Policisë së Burgjeve

*Enrik Sulejmani hezitoi të zbatonte urdhrin për transferimin nga spitali*

Drejtori i përgjithshëm i Policisë së Burgjeve, Enrik Sulejmani u shkarkua dje nga detyra pas mosmarrëveshjeve lidhur me transferimin e një të dënuari në spitalin e burgut. Shkarkimi i kreu të Policisë së Burgjeve ka ndodhur për çështjen e Ervis Martinajt. Policia e Burgjeve nuk arriti ta marrë Martinajn nga 'Spitali Amerikan 2', ku ndodhej i shtruar për shkak të plagëve që ka marrë në ngjarjen e 4 tetorit në Bllok. Dy ditë më parë pati tensione mes mjekëve të 'Spitalit Amerikan 2' dhe Policisë së Burgjeve, të cilët kërkuar të shoqëronin Martinajt në spitalin e burgut. Mjekët e 'Spitalit Amerikan 2' duke parë gjendjen shëndetësore të Martinajt nuk e firmosën fletëdaljen, duke krijuar një situatë të tensionuar brenda ambienteve të spitalit. Ndërkohë, Ministria e Drejtësisë jep detaje për largimin e Sulejmanit nga detyra dhe përplasjen e ditës së kaluar për transferimin e Ervis Martinajt në spitalin e burgut. Në deklaratën shpërndarë medive thuhet se ministria e Drejtësisë ka aprovuar propozimin e drejtorit të përgjithshëm të Burgjeve për largimin nga detyra të drejtorit të Policisë së Burgjeve, Enrik Sulejmani me motivacionin "Për mospërbushje të detyrave funksionale". "Ky vendim është marrë për shkak të mosekzekutimit të vendimit nr.1878, datë 07.10.2018 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë për vendosjen e masës së sigurimit 'arrest me burg' për shtetasin Ervis Martinaj. Ky shtetas për shkak të gjendjes shëndetësore ishte akomoduar në ambientet e 'Spitalit Amerikan', citohet në deklaratë, ku ndër të tjera thuhet se bazuar në vlerësimin e Institucionit të Mjekësisë Ligjore ka rezultuar se në gjendjen shëndetësore në të cilën ndodhet i paraburgosuri, trajtimi i tij mund të kryhet në Qendrën Spitalore të

### DEKLARATA E POLICISE

Policia në vendngjarje gjeti 11 gëzhoja, armë zjarri tip "Glock", 10 000 euro, aparate celularë dhe 3 automjete. Pak pas krimit, policia gjeti edhe një motor në zonën e Kopshtit Botanik, që dyshohet se ka lidhje me ngjarjen.

Burgjeve. "Për moszbatim të vendimit të gjykatës me masën e sigurisë 'arrest në burg' për Martinajn është kryer shkarkimi i drejtorit të Policisë së Burgjeve, Enrik

Sulejmani, me motivacionin e mospërbushjes së detyrave funksionale sipas ligjit në fuqi. Shtetasi Ervis Martinaj është shoqëruar në mjediset e Qendrës Spitalore të Burgjeve vetëm në mbërmbjen e datës 9 tetor. Qeveria shqiptare siguron çdo qytetar se ligji është i barabartë për të gjithë dhe kushdo që bëhet pengesë për zbatimin e tij do të marrë përgjigje shembullore", përfundon deklarata e ministrisë.



Vendi ku ndodhi ngjarja

### ARRATIA E AUTOREVE

Autorët e ngjarjes pas të shtënave kanë dalë me shpejtësi nga lokali. Në kamera duket që njëri prej tyre është larguar në këmbë në rrugicat e Bllokut, tjetri me makinë, ndërsa i treti nuk duket në pamjet e kamerave të sigurisë.



Këngëtarja në kërkim, iku nga Shqipëria më 5 tetor

Hyri dy herë në lokal, si tentoi Elvana Gjata të merrte të dashurin

Detaje të reja zbulohen nga shërr i së enjtes së 4 tetorit në zonën e Bllokut, që përfundoi me vrasjen e 28-vjeçarit Fabian Gaxha dhe plagosjen e dy të tjerëve, në një konflikt me të dashurin e këngëtares Elvana Gjata dhe miq të tij. Ndonëse nuk ishte e qartë masa e përfshirjes në ngjarje e këngëtares pasi u tha se ajo ishte larguar sapo kishte nisur shërr, burime të sigurt bëjnë me dije për "Balkan-Web" se Elvana ka hyrë brenda lokalit dy herë. Kanë qenë kamerat e një biznesi pranë vendit të ngjarjes që kanë kapur këngëtaresen edhe në momentin e ngacimit, edhe më pas kur ajo ka shkuar dy herë brenda, me sa duket për t'i thënë të dashurit të saj, Ervin Mata të largohet e të mos priste Ervis Martinajn për sqarime. Ndërkohë, dje u bë e ditur se Prokuroria ka urdhëruar shoqërimin e detyrueshëm të këngëtares, e cila ishte në lokalin ku ndodhi ngjarja. Shpallja në kërkim policor e detyron Gjatën që të paraqitet për të dhënë shpjegime brenda 30 ditëve, pasi duhet të jepte deklaratën e saj për ngjarjen. Këngëtarja u largua nga Shqipëria më 5 tetor, vetëm pak orë pas ngjarjes nga Rinasi drejt një vendi të BE. Në kërkim për ngjarjen janë shpallur edhe i dashuri i saj Ervin mata, Fabian Allushi, Mevjol Bilo, të cilët kanë qenë të ulur në një tavolinë.

### NJOFTIM SHITJE ME ANKAND

ZYRA PERMBARIMORE GJYQESORE PRIVATE 'ILIA ELEZI'

Pasuria nr. 1/165+1-8/1, LLOJI 'APARTAMENT', VOLUMI 6, FEAQE 179, SIPERFAQE 57 M2, ZONA KADASTRALE 8350, TIRANË, NË PRONËSI TË Z. PËLLUMB META DHE ZNJ. RITA META.

ÇMIMI 3.850.000 LEKË . Data e zhvillimit të ankandit do jetë 09.11.2018 .

CEL. 0684026666 ; 0693262866 .

**bashkëpunimi gjerman**  
DEUTSCHE ZUSAMMENARBEITUNG

Implemented by **giz** Deutsche Gesellschaft für Internationale Zusammenarbeit

**Programme: Harmonisation of economic and trade legislation with EU acquis" (EUH)**

The Deutsche Gesellschaft für Internationale Zusammenarbeit GmbH (GIZ) is a federal enterprise that supports the German Government in achieving its objectives in the field of international cooperation for sustainable development. The program: Harmonisation of economic and trade legislation with EU acquis" (EUH) support the Albanian institutions responsible for planning the accession process in implementing the Stabilisation and Association Agreement (SAA). The project aims at the approximation of laws to the EU acquis and is assigned to the sustainable economic development priority. It is aligned with the Albanian EU accession process, which is explicitly geared to membership in the European Union and accords top priority to reforming the national economic and legal system. The project focuses on further approximation of legal framework to EU acquis and on a coordinated implementation of economic and EU internal market law (Chapters 1,3,6,7,15,28 and 30 of EU acquis).

For the support of the EUH/GIZ programme team GIZ Office Albania seeks the following staff:

**CLEANER**

**OFFICE SERVICES:**  
The cleaner:  

- cleans the office premises, rooms, furniture, carpets and windows
- checks and refills office supplies and articles in the kitchen and WCs
- sets up and prepares the conference rooms as instructed
- provides services at meetings, e.g. serves coffee and tea for guests and visitors
- reports if stocks, e.g. of beverages are low, and need to be replaced
- prepare small lunch for programme staff (including purchase)
- assists with other office work

**QUALIFICATIONS:**  

- Primary school education
- At least 2-4 years' work experience in a comparable position
- Good communication skills
- Basic knowledge of foreign languages f.eg. English, German, etc.

**CONTRACT CONDITIONS:**  

- Part-time employment (50%)
- Programme office in Tirana
- Assignment period: 3 years and 8 months

Please forward your application until **20th of October 2018** to GIZ Office Albania by E-Mail: [giz-albanien-hr@giz.de](mailto:giz-albanien-hr@giz.de), including the following information: CV in English (Euro Pass format), references.

Only short-listed candidates will be contacted for interviews.

**GIZ is an equal opportunity employer and welcomes applications from all interested groups without any discrimination!**





Nehat Kulla, i dënuar me 20 vjet burg për vrasjen e Halim Gjuzit ka kërkuar liri me kusht, por pas 7 seancash gjyqësore, sot është tërhequr nga kjo kërkesë.

Më një vendim të papritur, Kulla u tërhoq nga kërkesa për lirim me kusht, duke u shprehur se kërkon të kryejë të gjithë dënimin e mbetur. "Kam respektuar lejet shpërblyese. Kam gruan në gjendje të rënduar shëndetësore. Pjesën e mbetur të dënim-it kërkoj ta kryej në shtëpi. Dua ta kryej gjithë dënimin", është shprehur ai para gjykatës, raporton "BalkanWeb". Nehat Kulla, i dënuar me 20 vite burg për vrasjen e shoferit ish-zv.ministrit të Arsimi, Halit Shamata qëndron në qeli prej vitit 2005.

**Burgu i Fushë-Krujës e rekomandoi për sjellje të mirë**

**Nehat Kulla tërhiqet nga kërkesa për liri**



Nehat Kulla

Shkresa e Burgut të Fushë-Krujës është e datës 21 qershor 2018 dhe thotë se Nehat Kulla ka marrëdhënie të mira me personelin dhe me bashkëvuajtësit e tjerë të dënim-it. "Ai ka zbatuar me

korrektësi rregulloren e institucionit dhe nuk është ndëshkuar me masa disiplinore. Rezultoni se gjatë periudhës së vuajtjes së dënim-it, i dënuari është përfshirë në organikën e të burgosurve të

punësuar, me familjarët dhe të afërmit ka marrëdhënie shumë të mira dhe mban kontakte të mira me ta", shkruan ndër të tjera rekomandimi i burgut të Fushë-Krujës. Sipas autoriteteve të burgut të Fushë-Krujës, Kulla është shpërblyer me 8 leje në total gjatë kohës që ka qëndruar në këtë burg dhe ka qenë korrekt duke i zbatuar ato. Nehat Kulla ka qenë në krye të një grupi kriminal në vitin 1997, i cili vepronte në zonën e Kinostudios dhe në Tufinë të Tiranës.

Ngjarja, në bulevardin "Zogu I", në Tiranë në maj 2015. Historia e hasmërisë që nisi në Holandë

**Burg përjetë vrasësit të "Camorra"-s**

*Salvatore Letizia mori pjesë në vrasjen e Mentor Lufit e Gerti Goxhajt*

TIRANE

Gjykata e Tiranës ka dhënë vendimin për tre të arrestuarit e masakrës në bulevardin "Zogu I", në Tiranë më 27 maj 2015, ku mbetën të vrarë Mentor Lufi, Gerti Goxhaj dhe Besnik Sulku. Gjykata ka dhënë 20 vjet burg për Klejvi Doçin, 27 vjet burg për vëllain e tij, Markeljan Doçi dhe burg përjetë për italianin Salvatore Letizia, i cili suar si vrasës me pagesë dhe pjesëtar i organizatës mafioze italiane "Camorra". Mësohet se asnjëri nga personat e pandehur nuk ishte i pranishëm në seancën gjyqësore. Dyshohet se ngjarja e ndodhur në Tiranë është një zinxhir hakmarrjesh që lidhet me vrasjen e Durim Sulkut në Holandë në prill të 2015.



Salvatore Letizia

ngritur nga lokali, ata kanë hipur në dy mjete dhe konkretisht Mentor Lufi ishte pasagjer në mjetin e drejtuar nga Gerti Goxhaj, ndërsa vëllezërit Markeljan dhe Klevi Doçi gjendeshin në një automjet pas të parit, ku në timon ishte Markeljan. Sapo kanë hipur në automjete, në dy pjesët anësore të makinës së parë janë afruar dy persona të armatosur, të cilët kanë qëlluar personat që gjendeshin në bordin e saj, konkretisht Mentor Lufin (Doçi) dhe Gert Goxhaj. Nga goditjet me armë ka vdekur në vend Goxhaj dhe është plagosur rëndë Lufi, i cili vdiq pak çaste më vonë. Në momentin e goditjes me armë, Markeljan Doçi afron me shpejtësi makinën drejt atentatorëve, duke përplasur fillimisht njërin prej tyre. Ky i fundit, i cili më pas rezultoi se ishte Besnik Sulku ka qëlluar me pistoletë në drejtim të mjetit të dytë, por pa u shkaktuar dëme tek vëllezërit Markeljan dhe Klevi Doçi. Të gjendur nën goditjen e armës tip pistoletë nga ana e Besnik Sulkut, Markeljan, gjithashtu i armatosur me pistoletë, ka reaguuar duke qëlluar me armë. Markeljan dhe Sulku kanë vijuar të qëllonjë njëri-tjetrin, derisa Besnik Sulku ka mbetur i vdekur, pak metra larg nga automjetet.

vonë, pranë një hoteli në atë zonë, u arrestua edhe shtetasi italian, Salvatore Letizia, i cili rezultoi se është personi që së bashku me Besnik Sulkun, ishte pjesë e vrasjes së shtetasve Mentor Lufi dhe Gerti Goxhaj. Në përfundim të hetimeve, bazuar në këqyrjen e vendit të ngjarjes, provave shkencore dhe bashkëpunimit me autoritetet holandeze, Prokuroria për Krimet të Rënda ka ngritur akuzat, si vijon: 1. Markeljan Doçi, lindur më 1981, në Bulqizë, akuzohet për kryerjen e veprave penale të: "Vrasjes me paramendim", kryer në bashkëpunim, në dëm të viktimës Durim Sulku (për ngjarjen në Holandë); "Vrasje e kryer me kapërcim të kufijve të mbrojtjes së nevojshme", në dëm të viktimës Besnik Sulku; "Mbajtje pa leje të armëve luftarake", dy herë. 2. Klejvi Doçi, lindur më 1993, në Bulqizë, akuzohet për kryerjen e veprave penale të "Vrasjes me paramendim", kryer në bashkëpunim, në dëm të viktimës Durim Sulku (për ngjarjen në Holandë) dhe "Mbajtje pa leje të armëve luftarake". 3. Salvatore Letizia, lindur më 1981, lindur Czazerta (Itali), akuzohet për kryerjen e veprave penale të: "Vrasjes me paramendim", kryer në bashkëpunim, në dëm të viktimës Mentor Lufi (Doçi) dhe "Mbajtje pa leje të Armëve Luftarake.

**VENDIMI I GJYQIT**

- 20 vite burg për Klejvi Doçin.
- 27 vite burg për Markeljan Doçin.
- Burg përjetë për Salvatore Letizian.

**SI NDDODHI NGJARJA? DOSJA E PROKURORISE**

Nga hetimet e Prokurorisë për Krimet të Rënda është arritur në përfundimin se ngjarja e ndodhur në muajin maj 2015 në Tiranë është vijim i një konflikti të nisur më parë po në kryeqytet, në dhjetor 2014 dhe që ka vazhduar në Holandë, në prill 2015 e më tej është shoqëruar me ngjarjen për të cilën akuzohen tre të pandehurit. Në bazë të veprimeve hetimore, Prokuroria për Krimet të Rënda i paraqet gjykatës dinamikën e ngjarjes, e cila është rindërtuar në bashkëpunim edhe me autoritetet holandeze. Në dhjetor 2014, shtetasi Men-

tor Lufi (Doçi) plagoset me armë zjarri në zonën e ish-stadiumit "Dinamo", në Tiranë dhe autorët largohen. Shënjestra e atentatit, Lufi, ka dyshuar se sulmi ndaj tij është organizuar nga vëllezërit Durim dhe Besnik Sulku. Ndërmjet Mentor Lufit dhe vëllezërve Sulku

kishte nisur një konflikt në Holandë, ku ata udhëtonin dhe qëndronin shpesh. Pas atentatit me pasojë plagosjen, Lufi organizon nipat e tij, Markeljan dhe Klevi Doçi për t'u hakmarrë. Në prill 2015, dy vëllezërit Doçi i bëjnë atentat me armë Durim Sulkut

në qytetin Ridderkerk të Holandës. Nga veprimet hetimore të autoriteteve holandeze rezultoi se Durim Sulku gjendej në një automjet tip "Smart", kur është qëlluar për vdekje disa herë me pistoletë nga Markeljan Doçi, i cili ishte i shoqëruar nga vëllai i tij, Klevi Doçi, gjithashtu i armatosur. Pas atentatit në Holandë, vëllezërit Doçi rikthehen në Shqipëri, duke iu shmangur autoriteteve holandeze. Pas thuasjes dy muajsh nga vrasja në Holandë, konkretisht pasditen e datës 27 majit 2015, Mentor Lufi, dy nipat e tij Markeljan e Klevi Doçi, si edhe miku i tyre, Gerti Goxhaj, gjendeshin në një lokal pranë Fakultetit të Shkencave, në bulevardin "Zogu i Parë" në Tiranë. Pasi janë

"Nipçja" i Ben Qimes ishte në masën e sigurisë "Detyrim paraqitje"

FIER

Një prej të "fortëve" të Fierit ka përfunduar në pranga në kuadër të operacionit "Forca e Ligjit". Bëhet fjalë për Ilir Boriçi, i cili u arrestua në flagrancë, pasi gjatë kontrollit i janë gjetur dhe sekuestruar dy pistoleta dhe një shpatë. Burime zyrtare nga policia lokale dje bënë me dije se 42-vjeçari është pjesë e grupit të quajtur "Boriçët", grup me precedentë kriminale, kryesisht në fushën e krimeve kundër personit.

#### ARRESTIMI

Të armatosur rëndë, me veshje e maska, efektive të FNSH-së dhe të policisë Fierit kanë ushtruar kontrolle të befashme nëpër lokale të dyshimta në këtë qytet për kapjen e personave që qarkullojnë me armë zjarri dhe personave të shpallur në kërkim. Kontrollat janë kryer jo vetëm në lokale, por edhe në ambiente të ndryshme si edhe në akset rrugore kryesore e dytësore të qytetit të Fierit dhe Lushnjës. "Në vijim të zbatimit të planit të masave për 'Kontrollin e territorit, parandalimin e ngjarjeve kriminale dhe kapjen e autorëve të ndryshëm të veprave penale' si edhe nga mbajtja nën vëzhgim e ambienteve që frekuentohen nga persona me precedentë kriminale, u bë i mundur arrestimi në flagrancë i shtetasit Ilir Boriçi", thuhet në njoftimin zyrtar të policisë. Sipas bluve, nga kontrolli i ushtruar në lokalitë në lagjen "8 Shkurti" Fier, 42-vjeçarit iu gjetën 2 armë zjarri pistoletë dhe një shpatë. Po të njëjtat burime sqaruan se Boriçi është arrestuar nga policia 5 herë për veprat penale "Tentativë vrasje", "Kanosje", "Shkatërrim prone" dhe "Armëmbajtje pa leje". Aktualisht 42-vjeçari ishte në masën "Detyrim paraqitje" për veprat penale "Armëmbajtje pa leje", "Kanosje" dhe "Shkatërrim prone". Ilir Boriçi ka lidhje familjare me një personazh tjetër të njohur në Fier dhe konkretisht Ben Qimen, një ndër personat më të kërkuar të drejtësisë italiane. Mësohet se Ben Qimja e prezantonte Boriçin si "nipçen" e tij, pasi ishte martuar me mbesën. Ndërkaq, po në kuadër të kontrolleve të ushtruara nga policia dhe FNSH-ja, u bë e mundur kapja dhe ndalimi i shtetasit të shpallur në kërkim Said Derwish, 25 vjeç, banues në Lushnje. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Lushnje ka caktuar masën e sigurimit "Arrest me burg" ndaj tij për veprat penale "Kanosje" dhe "Prodhimi dhe mbajtje pa leje e armëve dhe municionit luftarak". Ky shtetas, më 04.09.2018, në kodrat e fshatit Zhamë, gjatë një konflikti për motive pronësie ka qëlluar disa herë me armë zjarri automatik drejt vëllezërve N.M. dhe H.M..

# Kapet me pistoleta dhe shpatë në lokal, arrestohet i "forti" i Fierit, Ilir Boriçi

*Policia: Është prangosur 5 herë për tentativë vrasjeje kanosje, shkatërrim prone dhe armëmbajtje pa leje*



42-vjeçari i arrestuar, Ilir Boriçi



Shpata e sekuestruar e Ilir Boriçit



Policia gjatë kontrolleve në Fier

#### AKUZAT

Burime zyrtare nga policia e Fierit sqaruan se Ilir Boriçi është arrestuar 5 herë për veprat penale "Tentativë vrasje", "Kanosje", "Shkatërrim prone" dhe "Armëmbajtje pa leje". Aktualisht 42-vjeçari ishte në masën "Detyrim paraqitje" për veprat penale "Armëmbajtje pa leje", "Kanosje" dhe "Shkatërrim prone". Ilir Boriçi ka lidhje familjare me një personazh tjetër të njohur në Fier dhe konkretisht Ben Qimen, një ndër personat më të kërkuar të drejtësisë italiane.

## Vajza, policëve: Më shpëtoni, më ka rrëmbyer!

Tentoi të trafikonte të miturën në Greqi, përfundon në pranga 22-vjeçari Xhoni Qëndraj



torët në lidhje me operacionin "Four", që u zhvillua më 3 tetor të këtij viti, ku u dokumentuan të kryera prej grupit, pjesë e të cilit është edhe i riu, 10 vjeçdhje. Materialet në ngarkim të tij iu referuan prokurorisë për ve-

prat penale "Trafikimi i të miturve" dhe "Mosbindja ndaj urdhrave të punonjësit të policisë së rendit publik".

#### DENONCIMI

Ka qenë 17-vjeçarja me inicialet F.A., ajo që denoncoi tek shërbimet policore të

Kufirit në Zminec, duke kërkuar ndihmë prej tyre për ta shpëtuar. "Më shpëtoni nga ky. Më ka rrëmbyer", u ka thënë vajza policëve të Zminecit, sa i pa të afroreshin drejt saj. Ajo ka dhënë të njëjtën dëshmi edhe në Komisarriatin e Policisë në Sarandë. "Më ka rrëmbyer në lagjen time në Vlorë dhe me forcë më ka hipur në një makinë. Gjatë rrugës më thoshte se do të më çonte në Greqi", është shprehur 17-vjeçarja. Ndërsa, mësohet se gjendja e saj ka qenë tepër e rënduar. F.A. është femijë e dy prindërve të divorcuar prej vitesh dhe jeton me nënën. Këtë fakt e ka dëshmuar edhe para bluve. "Nuk kam njeri që të më mbrojë, më mbronin ju", është shprehur 17-vjeçarja.



I dënuar me 8 vite burg në Itali për trafik heroine, kapet i shumëkërkuari me 3 emra

**DURRËS** - Një 53-vjeçar është arrestuar ditën e djeshme, pasi ishte në kërkim ndërkombëtar. Mësohet se shërbimet e Drejtorisë Vendore të Policisë Durrës, në bashkëpunim me Interpol Tiranë, pas informacioneve të marra në rrugë operative për një shtetas të dënuar në Itali dhe si rezultat i kontrolleve të befashme kanë bërë të mundur lokalizimin dhe kapjen e tij dhe konkretisht të Ferdinand Tare (Ferdinand Luka, Alfred Daja), banues në Durrës. Blutë e qytetit bregdetar sqaruan se 53-vjeçari ishte i shpallur në kërkim ndërkombëtar nga Interpol Roma/Itali, më datë 05.10.2018, pasi autoritetet gjyqësore Bari-Itali e kanë dënuar atë me 8 vjet 2 muaj e 18 ditë për veprat penale "Organizatë kriminale, me qëllim trafikimin e lëndëve narkotike të llojit heroine". Po ditën e djeshme, gjatë kontrolleve të ushtruara nga blutë është kapur edhe një tjetër person i kërkuar, ndërsa janë shoqëruar për verifikim 14 persona me precedentë penalë në fushën e narkotikëve, vjedhjes së pronës dhe krimeve ndaj jetës. Sipas policisë, kontrollet do vijojnë në të gjithë territorin e qarkut Durrës për kapjen e personave në kërkim për vepra të ndryshme penale, të atyre që qarkullojnë me armë zjarri, apo kryejnë trafike të paligjshme.



**DURRËS** - "Unë kërkoj me çdo kusht të gjendet vrasësi i tim biri. Kërkoj hetuesi speciale. Unë kam fakte. U kam shkruar të gjitha instancave shtetërore. Jam tejet i shqetësuar, pasi shteti nuk ka bërë asgjë për zbardhjen e ngjarjes". Kështu është shprehur dje Bajram Cani, i cili vazhdon të kërkojë drejtësi për të parë pas hekurave autorët e krimit. Apeli i të moshuarit vjen pesë vite nga vrasja e biznesmenit të ndërtimit, Plarent Cani në zonën e plazhit të Durrësit. I ati i biznesmenit kërkon drejtësi që të hidhet dritë mbi ngjarjen ku i mbeti i vrarë djali, baba i tre fëmijëve të mitur. Biznesmeni Plarent Cani u ekzekutua me katër plumba, dy në kokë e dy në zemër në një atentat të mirorganizuar. Ngjarja e rëndë ndodhi me 2 shtator të vitit 2013, rreth

**"Kaluan 5 vjet, shteti 'sbëri asgjë për zbardhjen e ngjarjes"**

**Biznesmeni Plarent Cani u ekzekutua me 4 plumba, babai: Kërkoj me çdo kusht të gjendet vrasësi**



Bajram Cani, duke folur për "GSH"



**NGJARJA**

Biznesmeni Plarent Cani u ekzekutua me katër plumba, dy në kokë e dy në zemër në një atentat të mirorganizuar. Ngjarja e rëndë ndodhi më 2 shtator të vitit 2013 rreth orës 8:30 të mëngjesit, në sektorin "Teuta" në plazhin e Durrësit, pak metra larg prej themeleve të një pallati që po ndërtohej nga viktima.

orës 8:30 të mëngjesit, në sektorin "Teuta" në plazhin e Durrësit, pak metra larg prej themeleve të një pallati

që po ndërtohej nga viktima. Dy persona të maskuar, të cilët lëviznin me motor e kanë qëlluar me pistoletë bi-

znesmenin dhe janë larguar me shpejtësi nga vendi i krimit. Pas vrasjes, burime policore të asaj kohe bënë me dije



se pista kryesore e hetimeve ishte për larje hesapësh. Kjo për shkak të së kaluarës së viktimit në shtetin italian, por nuk u përjashtua edhe ndonjë konflikt pronësie për tokën ku po ndërtohej pallati. "Ka pesë vjet që mu vrra djali. Gjatë kësaj kohe

u kam dërguar disa shkresa ish-prokurorit të përgjithshëm, kryeprokurores aktuale, kryeministrin Rama dhe nuk kam marrë asnjë përgjigje. Çfarë shteti është ky", u shpreh i indinjuar babai i biznesmenit të vrarë.

Policia shoqëron 20 persona. Ngjarja dyshohet të ketë ndodhur për motive pronësie

**Vrasja në Lushnje, ish-kryeplaku u qëllua në pritë me një plumb në kokë**

*Banorët: Viktima po kthehej nga lokali i vëllait, u ekzekutua afër portës së shtëpisë*

**LUSHNJE**

Vrasja me plumb në kokë e ish-kryeplakut të fshatit Shegas në Lushnje, Qemal Alla ka alarmuar policinë, e cila së bashku me prokurorinë po hetojnë intensivisht për zbardhjen e plotë të kësaj ngjarjeje. Një ditë pas atentatit ku humbi jetën 48-vjeçari, blutë kanë shogëruar dhe marrë në pyetje mbi 20 persona. Mësohet se ngjarja ka ndodhur mbremjen e së martës, teksa Qemal Alla ishte duke u kthyer në shtëpi, pasi kishte qenë për të pirë kafe në lokalin e të vëllait në fshat. Një ditë pas ekzekutimit në pritë të ish-kryeplakut janë zbardhur detaje të reja. Sipas hetuesve të çështjes, por edhe dëshmitë të dhëna nga banorët, Qemal Alla është qëlluar për vdekje afër banesës së tij (rreth 100 metra) nga një person që i kishte zënë pritë. Nga hetimet paraprake, dyshohet se autori i krimit ka qenë i fshehur mirë dhe e ka qëlluar në befasi 48-vjeçarin. Më pas agresori është larguar pa u vënë re nga askush, i ndihmuar edhe nga errësira. Grupi hetimor është hetuar në disa pista, ku nuk përjashtohet mundësia që Qemal Alla të jetë vrarë për motive pronësie, konkurrence, apo një grabitjeje të mundshme. Nga ana tjetër, të afërmit e vik-



Ish-kryeplaku i fshatit Shegas në Lushnje, Qemal Alla

timës u shprehën dje për "Gazeta Shqiptare" se Qemal nuk ka shfaqur ndonjë shqetësim për të dyshuar në lidhje me ndonjë problem që mund të kishte. Ata thanë se gjatë gjithë kohës, ai ka qenë i qetë dhe se në dijeninë e tyre nuk ka pasur konflikte me persona të tjerë.

**NGJARJA**

Rreth orës 21:30, ish-kryeplaku Qemal Alla ka dalë nga lokali i fshatit që është në pronësi të vëllait të tij. Ai ka qenë duke udhëtuar me makinën e tij tip fuoristradë për në drejtim të shtëpisë së vet, kur një person i ka zënë pritë duke e qëlluar e lënë të vdekur në vend. Krisma

e armës ka alarmuar familjarët dhe fqinjët, të cilët e kanë gjetur të pajetë 48-vjeçarin. Pas sinjalizimit për vrasjen, forcat policore të Lushnjës, të Pierit si dhe FNSH-ja kanë mbërritur në vendngjarje. Mësohet se në ndihmë të grupit hetimor kanë shkuar një grup ekspertësh të hetimit nga Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit. Viktima është dërguar në morgun e spitalit të Lushnjës, ndërsa policia ka nisur hetimet dhe ka marrë në pyetje edhe familjarët e viktimit, i cili jetonte vetëm me bashkëshorten, kurse djali është emigrant në Greqi. Pas kryerjes së veprimeve hetim-



Vendi ku ndodhi ngjarja

more paraprake, hetuesit e çështjes pohuan se 48-vjeçari nuk ka qenë person problematik dhe me precedent penal. Në fshat, Alla njihje si person i qetë dhe pa konflikte. Paraprakisht dyshohet se krimi mund të ketë ndodhur për motive pronësie ose konkurrence, pasi viktima kishte një rezervat peshku dhe ishte prodhues i fidanëve të ullirit.

**BANORËT**

Pas ngjarjes së rëndë, banorët e fshatit Shegas kanë deklaruar se kanë dëgjuar një krismë arme. Mund të na thoni se çfarë ndodhi mbremjen e së martës?

Dëgjuam një zhurmë, Baf.

Çfarë bëtë më pas, dolët e patë jashtë?

Ku të shihje. Le që ishte natë.

Sa krisma dëgjuat dhe dini gjë se kush mund të ketë qëlluar?

Vetëm një krismë. Autori ka qëlluar vetëm një fishek. Një tek. S'e dimë kush e ka bërë.

Ku e kanë qëlluar viktimiten?

Qemali ka ardhur për në shtëpi, pasi ishte në lokalin e fshatit për të pirë një kafe. Sa ka mbërritur, ka hapur portën për të hyrë brenda dhe aty është qëlluar.

Sa larg banesës ndodhet lokali?

100-200 metra larg është.



Pëllumb Petritaj

**Falsifikim e pastrim parash, bie nëpranga biznesmeni**

**VLORË** - Policia e Vlorës ka arrestuar biznesmenin Pëllumb Petritaj, pasi akuzohet për falsifikim dokumentesh e pastrim parash. Mësohet se 54-vjeçari u pranog nga Seksioni i Krimit Ekonomik e Financiar, sepse dyshohet të ketë falsifikuar dokumentet e një toke në zonën e Zvërnecit. "Shërbimet e Policisë kanë bërë ndalimin e tij, pasi ky shtetas dyshohet të jetë autor i kryerjes së veprave penale "Falsifikimi i dokumenteve" dhe "Pastrimi i produkteve të veprës penale". Nga hetimet e kryera, dyshohet se Pëllumb Petritaj ka falsifikuar dokumentacionin e origjinës në lidhje me një sipërfaqe toke prej 100 ha në zonën e Zvërnecit. Për këto vepra penale, Gjykata e Shkallës së Parë Vlorë i ka caktuar masën e sigurisë "Arrest në burg", thuhet ndër të tjera në njoftimin zyrtar të policisë. Mësohet se biznesmeni ka pasur postin e kryetarit të Partisë Republikane të Vlorës. Ai ka qenë në mesin e personave të akuzuar edhe për falsifikimin e tokave në Karaburun, por ka dalë i pajfajshëm.

# BLUZAT E BARDHA PAGAT

Këshilli i Ministrave: Vjetërsia në punë, 2% më shumë nga masa e përcaktuar

## Vendimi, rritje pagash për mjekët e infermierët, kush përfiton

Zbardhen ndryshimet, shtesa që do të marrë secila kategori

Voltiza Duro

Mjekët, infermierët dhe punonjësit me arsim të lartë që janë pjesë e sistemit të shëndetësisë do të përfitojnë rritje page. Vendimi është marrë nga Këshilli i Ministrave dhe ka hyrë në fuqi, menjëherë pas botimit në Fletoren Zyrtare. "Gazeta Shqiptare" zbardh sot vendimin e qeverisë dhe rritjet e pagave për secilën kategori përfituese që është pjesë e sistemit shëndetësor në vend. Kështu, shtesa në pagesë për vjetërsi pune do të ketë një vlerë 2% më të lartë krahasuar me vitin e kaluar. Por, gjithashtu, shtesë në rrogë do të ketë edhe për kualifikimet që disponojnë punonjësit; për pozicionin që kanë; si dhe për kushtet e punës në të cilat ushtrojnë profesionin.

### VENDIMI I QEVERISË

Këshilli i Ministrave ka marrë vendimin për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr 555, datë 11.8.2011 "Për miratimin e strukturës dhe të niveleve të pagave të punonjësve me arsim të lartë në sistemin e Ministrisë së Shëndetësisë dhe Spitalin Ushtarak Qendror Universitar, në sistemin e Ministrisë së Mbrojtjes, të punonjësve të infermieristikës në sistemin e Ministrisë së Shëndetësisë e Ministrisë së Mbrojtjes, si dhe për trajtimin e mjekëve në strukturat e forcave të armatosura". "Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 7, të ligjit nr. 152/2013, "Për nëpunësin civil", të ndryshuar, të pikës 2, të nenit 4, të ligjit nr. 10405, datë 24.3.2011, "Për kompetencat për caktimin e pagave dhe të shpërblimeve", si dhe të ligjit nr. 109/2017, "Për buxhetin e vitit 2018", me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave vendosi: Në vendimin nr. 555, datë 11.8.2011, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, bëhen ndryshimet dhe shtesat si më poshtë vijojnë: a) Në lidhjen nr. 1, të përmendur në pikën 2, bëhen ndryshimi dhe shtesa e mëposhtme: i. kreu 1.2 zëvendëso-



Struktura dhe nivelet e pagave për punonjësit e Operatorit të Shërbimeve të Kujdesit Shëndetësor

I. Në drejtorinë qendrore dhe në drejtoritë rajonale

EMËRTIMI	PAGA MUJORE					Totali
	Paga e grupit (PG)	Shtesa për vjetërsi (SHV)	Shtesa për kualifikim (SHK)	Shtesa për pozicion (SHP)	Shtesa për kushte pune (SHKP)	
	1	2	3	4	5	nga ... deri ... lekë
1 Drejtor i përgjithshëm	1	2%		118.100		
2 Zëvendësdrejtor i përgjithshëm	1	2%		100.000		
Drejtor drejtorie në drejtorinë qendrore.						
3 Drejtor i drejtorisë rajonale.	1	2%		95.000		
4 Përgjegjës sektori në drejtorinë qendrore. Drejtor drejtorie në drejtorinë rajonale.	1	2%		80.700		
5 Përgjegjës sektori në drejtorinë rajonale.	1	2%		61.000		
6 Specialist (niveli i parë)	1 ose 2, ose 3	2%		49.000		
7 Specialist (niveli i dytë)	1 ose 2, ose 3	2%		38.000		

II. Në njësitë vendore të kujdesit shëndetësor

EMËRTIMI	PAGA MUJORE					Totali
	Paga e grupit (PG)	Shtesa për vjetërsi (SHV)	Shtesa për kualifikim (SHK)	Shtesa për pozicion (SHP)	Shtesa për kushte pune (SHKP)	
	1	2	3	4	5	nga ... deri ... lekë
1 Titullat i njësitë vendore të kujdesit shëndetësor me qendrë në qafë	1	2%		90.800		
2 Titullat i njësitë vendore të kujdesit shëndetësor me qendrë në bashkë	1	2%		80.700		
3 Shëf shërbimi	1	2%		64.000		
4 Përgjegjës sektori	1	2%		42.000		
5 Përgjegjës i shërbimeve të shëndetit	1	2%		49.500	5.000	
6 Mjek/specialist në shërbimet e shëndetit publik	1	2%		42.000	7.000	
7 Mjek/stomatolog/farmacit/inxhinier	1	2%		42.000		
8 Mjek/psikolog/punonjës social që punojnë në shërbimet e shëndetit mendës	1	2%		42.000	5.000	
9 Specialist	1 ose 2, ose 3	2%		38.200		
10 Karyeinfermieret/karyevaksinator	1	2%		35.200		
11 Teknik specialitetesh shëndetësore	1 ose 2, ose 2, ose 3, ose 4 ose 5	2%		31.000	1.100	
12 Infermier në shërbimet e shëndetit mendës	1 ose 2, ose 2, ose 3, ose 4, ose 5	2%		31.000	5.000	
13 Infermier	1 ose 2, ose 2, ose 3, ose 4, ose 5	2%		31.000		

### SHTESA

Shtesa në pagesë për vjetërsi pune do të ketë një vlerë 2% më të lartë krahasuar me vitin e kaluar. Por, gjithashtu, shtesë në rrogë do të ketë edhe për kualifikimet që disponojnë punonjësit, për pozicionin që kanë, si dhe për kushtet e punës në të cilat ushtrojnë profesionin.

### KATEGORITË

Në fushën e veprimit të këtij vendimi përfshihen: a) mjekët dhe punonjësit e tjerë me arsim të lartë të sistemit të Ministrisë së Shëndetësisë; b) mjekët dhe punonjësit e tjerë me arsim të lartë, civilë në Spitalin Ushtarak Qendror Universitar në sistemin e Ministrisë së Mbrojtjes; etj.

het me kreu 1.2, me titull "Struktura dhe nivelet e pagave për punonjësit e Operatorit të Shërbimeve të Kujdesit Shëndetësor", që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij; b) Në lidhjen nr. 2, të përmendur në pikën 3, kreu 2.2 shfuqizohet. 2. Efektet financiare, për vitin 2018, të përballohen nga fondet e miratuara për Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, për këtë vit dhe të fillojnë: a) Për punonjësit e Operatorit të Shërbimeve të Kujdesit Shëndetësor, nga momenti i transferimit të punonjësve në pozicionet e reja pas miratimit të strukturave dhe të organikave përkatëse; b) Për parashikimet e tjera, nga data e hyrjes në fuqi të këtij vendimi", theksohet në vendimin e qeverisë. Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

### PËRFITUESIT

Në fushën e veprimit të këtij vendimi përfshihen: mjekët dhe punonjësit e tjerë me arsim të lartë të sistemit të Ministrisë së Shëndetësisë; mjekët dhe punonjësit e tjerë me arsim të lartë, civilë në Spitalin Ushtarak Qendror Universitar në sistemin e

Ministrisë së Mbrojtjes; infermierët e sistemit të Ministrisë së Shëndetësisë; infermierët e sistemit të Ministrisë së Mbrojtjes. "Struktura dhe nivelet e pagave për punonjësit me arsim të lartë, të përmendur në pikën 1, shkronjat "a", "b", "c" dhe "ç" të këtij vendimi, caktohen sipas lidhjes nr.1 (kreu 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8, 9, 10) dhe lidhjes nr.2 (kreu 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7), që i bashkëlidhen këtij vendimi dhe janë pjesë përbërëse të tij. 3. Paga e grupit, kolona 1: a) e lidhjes nr.1, diplomë e shkollës së lartë, është 13 000 (trembëdhjetë mijë) lekë në muaj; b) e lidhjes nr.2 përcaktohet sipas lidhjes nr.3, bashkëlidhur këtij vendimi. - "Paga e grupit 1" u jepet punonjësve me diplomën e shkollës së lartë të infermierisë. - "Paga e grupit 2" u jepet punonjësve me: a) diplomë të shkollës së mesme mjekësore; b) diplomën e shkollës së mesme dhe dëshminë e kualifikimit të kurseve 1- dhe 2-vjeçare, për degën infermier/mami, ndihmësinfermier/ndihmësmami. - "Paga e grupit 3" u jepet punonjësve me arsim nëntëvjeçar", thuhet në vendim.



# PENSIONET E PLEQËRISË KOEFIKIENTËT E RINJ

Tabela e plotë/ Formula e saktë për përcaktimin e masës së pensioneve të pleqërisë

Voltiza Duro

Qeveria ka miratuar koeficientët e rinj të indeksimit të pagave për vitin 2018, në bazë të së cilëve do të përllogariten pensionet. Vendimi i Këshillit të Ministrave është publikuar ditën e djeshme në Fletoren Zyrtare dhe ka hyrë në fuqi menjëherë. "Gazeta Shqiptare" publikon sot tabelën me koeficientët e rinj të indeksimit, sipas të cilëve pensionistët mund të përllogarisin masën që iu takon për vitet që kanë punuar me kontribute. Në vitin 2018, pagat mbi të cilat janë paguar kontributet e sigurimeve shoqërore deri në vitin 2017, pas indeksimit të tyre me koeficientët vjetorë të përcaktuar në këtë vendim nuk mund të jenë më të lartë se trefishi i pagës minimale në shkallë vendi, e përcaktuar me vendim të Këshillit të Ministrave për efekt të pagimit të kontributeve të sigurimeve shoqërore në vitin 2018, për pagat nga viti 2002 e në vazhdim. "Efekti financiar që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, lidhen me zbatimin e formulës së caktimit të pensioneve, aplikohen vetëm për pensionet që caktohen me datë fillimi nga 1.1.2018 e në vazhdim dhe përballohen brenda buxheteve vjetore, të miratuara për Institutin e Sigurimeve Shoqërore", nënvizon Këshilli i Ministrave.

**KOEFIKIENTËT**

Koeficientët e indeksimit të pagave, të përcaktuar në vendimin nr. 927, datë 29.12.2014, të Këshillit të Ministrave, "Për koeficientët e indeksimit të pagave, për efekt të llogaritjes së bazës së vlerësuar për llogaritjen fillestare të pensioneve", mbeten në fuqi dhe përdoren për indeksimin e pagave mbi të cilat janë paguar kontributet vetëm për pensionet me datë fillimi deri më 31.12.2017, përshirë edhe këtë datë. "Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 10, paragrafi i dytë, e 59, pika 1, të Ligjit nr. 7703, datë 11.5.1993, "Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave që

## Vendimi i qeverisë: Sa do të jenë koeficientët e përllogaritjes së pensioneve në 2018-ën

Sa ju takon për vitet e punës me kontribute



1

### JANAR 2018, KONTRIBUTET

Koeficientët e indeksimit të pagave, mbi të cilat janë paguar kontributet për sigurimet shoqërore të detyrueshme, për efekt të llogaritjes së bazës së vlerësuar për llogaritjen fillestare të pensioneve, me datë fillimi 1.1.2018 dhe në vazhdim, sipas viteve, të jenë si në tabelë", - theksohet në vendim.

### PAGAT

Pagat mbi të cilat janë paguar kontributet e sigurimeve shoqërore deri në vitin 2017, pas indeksimit të tyre me koeficientët vjetorë të përcaktuar në këtë vendim nuk mund të jenë më të larta se trefishi i pagës minimale në shkallë vendi.

koeficientët e indeksimit të pagave, mbi të cilat janë paguar kontributet për sigurimet shoqërore të detyrueshme, për efekt të llogaritjes së bazës së vlerësuar për llogaritjen fillestare të pensioneve, me datë fillimi 1.1.2018 dhe në vazhdim, sipas viteve, të jenë si në tabelë", - theksohet në vendim. Për zbatimin e këtij vendimi është ngarkuar Instituti i Sigurimeve Shoqërore. Koeficientët e indeksimit janë ata koeficientët që kërkohen që pagën mbi të cilën janë paguar kontributet, ta aktualizojnë e ta sjellin në nivelin e vlerës së pagës sot, pra t'i heqin efektin "gërryes" të inflacionit.

Paga e një mësuesi që ka filluar punën me kontribute në 1975-ën, deri në janar në 94-ën, me gjithë indekset e ndryshimet që kanë ndodhur, është e tillë që shkon 4110 lekë. Kjo pagë, indeksohet sot me një koeficient 8.59. Pra, ajo pagë mësuesi që ka qenë 7 mijë lekë të vjetra, po ta aktualizojmë sot del 360 mijë lekë të vjetra. Edhe kjo indeks sot është i përshkallëzuar, e fillojnë nga 94' deri në momentin që del në pension. Viti 2018 nuk ka indeks, kurse viti 2014, 2015 kanë koeficientët respektivë. Ndërkohë pasi bëhet indeksimi, formula sesi llogaritet baza e vlerësuar mesatare është formu-

la e bazës mesatare të vlerësuar të ponderuar, pra merren pagat për periudhën deri në vitin 1994, llogaritet një pagë e kjo ponderohet me vitet e punës. Individit edhe mund të ketë ndryshuar pozicion pune që ka pasur rrogë më të lartë, por edhe kjo indeksohet e del vlerë më e lartë. Në këto kushte gjithë periudha ponderohet, e individit i del një pagë mesatare bazë e vlerësueshme, e cila shumëzohet me 40%, në rastet kur ka punuar 40 vite (1% për çdo vit pune). Pas kësaj del një vlerë së cilës i shtojmë edhe pensionin social dhe marrim vlerën përfundimtare të pensionit të pleqërisë. Nëse baza mesatare e vlerësuar del në vlerë më të madhe, po ashtu do të rezultojë edhe pensioni. Kjo është mënyra më e thjeshtë për llogaritjen e pensionit.

### FORMULA E LLOGARITJES

Formula e përllogaritjes së pensionit të pleqërisë është: Pension social (bazë) plus një shtesë që është 1% për çdo vit sigurimi, për çdo vit punë, të bazës mesatare të vlerësuar për gjithë periudhën që individit ka paguar kontributet. Një qytetar që ka filluar punën në vitin 1975 deri në 2018-ën, pa ndërprerje, pra ka 43 vite pune me kontribute. Pensioni do të llogaritet nga viti 75' kur individit ka filluar punë për herë të parë, deri në

KOEFIKIENTËT E INDEKSIMIT TË PAGAVE	
Për pagat referuese deri më 1.1.1994 8.76;	
◆ Për pagat e vitit 1994	8.76;
◆ Për pagat e vitit 1995	7.05;
◆ Për pagat e vitit 1996	5.47;
◆ Për pagat e vitit 1997	5.47;
◆ Për pagat e vitit 1998	4.57;
◆ Për pagat e vitit 1999	3.71;
◆ Për pagat e vitit 2000	3.38;
◆ Për pagat e vitit 2001	2.89;
◆ Për pagat e vitit 2002	2.67;
◆ Për pagat e vitit 2003	2.39;
◆ Për pagat e vitit 2004	2.17;
◆ Për pagat e vitit 2005	1.97;
◆ Për pagat e vitit 2006	1.79;
◆ Për pagat e vitit 2007	1.71;
◆ Për pagat e vitit 2008	1.51;
◆ Për pagat e vitit 2009	1.39;
◆ Për pagat e vitit 2010	1.33;
◆ Për pagat e vitit 2011	1.28;
◆ Për pagat e vitit 2012	1.23;
◆ Për pagat e vitit 2013	1.18;
◆ Për pagat e vitit 2014	1.18;
◆ Për pagat e vitit 2015	1.02;
◆ Për pagat e vitit 2016	1.02;
◆ Për pagat e vitit 2017	1.00;
◆ Për pagat e vitit 2018	1.00.

**FORMULA**

Formula e përllogaritjes së pensionit të pleqërisë është: pension social (bazë) plus një shtesë që është 1% për çdo vit sigurimi, për çdo vit punë, të bazës mesatare të vlerësuar për gjithë periudhën që individit ka paguar kontributet.

2018-ën me pagat që ai ka gëzuar. Por meqenëse gjatë viteve të tranzicionit, u dëmtua dokumentacioni dhe nuk mund të gjendeshin dokumentet e pagave për pensionistët, në 2007-ën, u mor një vendim i Këshillit të Ministrave që quhet "Vendimi i Këshillit të Ministrave për pagën mesatare për bazën e vlerësuar për efekt llogaritje të pensioneve" ose siç quhet ndryshe paga referuese. Ky është një vendim unik që ka të përcaktuar në disa tabela të veçanta llojin e punës që ka bërë individit nga dita që ka filluar punën deri në ditën që e ka lënë atë. Ndërkohe në rastin kur një individ

ka qenë mësues për 40 vite dhe ka pasur një pagë mësuesi, duhet që patjetër këtë funksion që ka pasur ta ketë të shprehur qartë në librezën e punës. Pra, këtij individit nuk i kërkohen vërtetime pagash nga viti që ka filluar punën por vetëm një librezë pune e pastër, e plotësuar sipas dispozitave të kohës dhe e pakorrigjuar, e pandërhyrë brenda saj. Ky është një dokument themeltar mbi të cilin llogaritet pensioni para vitit 93'. Këto paga referuese i shërbejnë individit nga dita që ka filluar punë deri në 31 dhjetor të 1993-it e këto paga kanë koeficientët e vet të indeksimit.

**Nisma për hapjen e klasave në gjuhën e kësaj kategorie**

**Tekste falas për nxënësit e arsimit bazë të pakicave kombëtare në Shqipëri**



Me propozimin e ministres së Arsimit, Sportit dhe Rinisë, Këshilli i Ministrave vendosi që të pajisen me tekste falas të gjithë nxënësit e arsimit bazë të pakicave kombëtare, të cilët mësojnë dhe/ose mësohen në gjuhën e pakicës kombëtare, u sigurohen tekste shkollorë falas. Ndërkohë ministria përgjegjëse për arsimin bashkërendon punën me institucionet publike të arsimit të lartë, që kanë në objekt të veprimtarisë së tyre mësimorë dhe shkencorë shkencaat shoqërore, sociale dhe ato të edukimit, për nevojat e formimit fillestar për mësimin në gjuhën e pakicave kombëtare.

**TRAJNIMI I MËSUËSVE**

Mësuesit trajnohen, të paktën 3 (tri) ditë në vit, me programe trajnimi të akredituara. Njësitë arsimore vendore organizojnë, koordinojnë dhe mbështesin zhvillimin e vazhdueshëm profesional të mësuesve në nivel institucioni arsimor.

Trajnimi dhe zhvillimi profesional i mësuesve që zhvillojnë mësim në gjuhën e pakicave kombëtare financohet me fondet e buxhetit të shtetit. Mësuesit trajnohen, të paktën 3 (tri) ditë në vit, me programe trajnimi të akredituara.

Njësitë arsimore vendore organizojnë, koordinojnë dhe mbështesin zhvillimin e vazhdueshëm profesional të mësuesve në nivel institucioni arsimor. Procedurat e trajnimit dhe zhvillimit profesional të mësuesve në nivel institucioni

arsimor përcaktohen me udhëzim të ministrit përgjegjës për arsimin. "Nisma për hapjen e klasave në gjuhën e pakicave kombëtare mund të merret nga: Njësia e vetëqeverisjes vendore përkatëse; Njësia arsimore vendore përkatëse; Komuniteti i zonës, ku pritet të hapen klasa të pakicave kombëtare. Për hapjen e klasave në gjuhën e pakicave kombëtare, kryetari i bashkisë dhe titullari i njësisë përkatëse arsimore vendore, pas konsultimit me përfaqësues të pakicave kombëtare, i paraqesin propozimin përkatës ministrit përgjegjës për arsimin", -

thuhet në vendim. Propozimi për hapjen e klasave në gjuhën e pakicave kombëtare në institucionet arsimore parauniversitare publike shoqërohet me studimin mbi argumentimin e domosdoshmërisë së hapjes së klasave me nxënës të pakicave

kombëtare, si dhe me kontributin e njësisë së vetëqeverisjes vendore. Propozimi për hapjen e klasave në gjuhën e pakicave kombëtare paraqitet jo më vonë se 6 (gjashtë) muaj para fillimit të vitit mësimor.

Këshilli i Ministrave/ Njehsimi i diplomave të huaja, 2000 mijë lekë për çdo aplikant

**Vendimi, zbardhen tarifat për provimet e specializantëve të Mjekësisë**

*Sa do të paguhet për testin e profesioneve të rregulluara*

Voltiza Duro

Të gjithë ata që do të japin provime për profesionet e rregulluara, kërkojnë njehsimin e diplomave, apo bëjnë testimin e specializimit në mjekësi, tashmë mund të njihen me tarifat që duhet të paguajnë. "Gazeta Shqiptare" zbardh sot vendimin më të fundit të qeverisë dhe tarifat përkatëse që duhet të paguajnë të sipërpërmendurit. Këshilli i Ministrave në vendimin më të fundit ka përcaktuar tarifat për shërbimet e ofruara nga Qendra e Shërbimeve Arsimore për qytetarët, institucionet e arsimit të lartë, institucionet e tjera dhe palët e treta. "Tarifat e përcaktuara sipas pikës 1 të këtij vendimi, arkëtohen, parapaguhet para ofrimit të shërbimit përkatës, pranë bankave të nivelit të dytë ose zyrate të Postës Shqiptare, në adresë të Degës së Thesarit Tiranë, me përfuttes Qendrën e Shërbimeve Arsimore, Tiranë. Të ardhurat e arkëtuara nga tarifat e parapaguara për shërbimet e ofruara nga Qendra e Shërbimeve Arsimore janë të pakthyeshme. Pjesa prej 90% e të ardhurave, që i takon Qendrës së Shërbimeve Arsimore, autorizohet dhe përdoret me strukturë të veçantë buxhetore në programin buxhetor 09450, kapitulli 06, "Të ardhurat e veta jashtë limitit", theksohet në vendim. Ndërkohë të ardhurat që sigurohen nga këto tarifa menaxhohen nga Qendra e Shërbimeve Arsimore dhe përdoren për mbulimin e shpenzimeve të personelit të Qendrës së Shërbimeve Arsimore ku në shpenzime personale përfshihen pagat e punonjësve, si dhe kontributet për sigurimet shoqërore e shëndetësore. Gjithashtu, këto të ardhura përdoren edhe për mbulimin e shpenzimeve të veprimtarisë së Qendrës së Shërbimeve Arsimore, ku përfshihen dhe mbulimi i shpenzimeve të hartimit, vlerësimit e korigjimit të



**PAGESAT**

"Tarifat e përcaktuara sipas pikës 1 të këtij vendimi, arkëtohen, parapaguhet para ofrimit të shërbimit përkatës, pranë bankave të nivelit të dytë ose zyrate të Postës Shqiptare, në adresë të Degës së Thesarit Tiranë, me përfuttes Qendrën e Shërbimeve Arsimore, Tiranë", - theksohet në vendimin e Këshillit të Ministrave.

testeve të provimeve, si dhe pagesa e kuotave/tarifave në rrejet ndërkombëtare; si dhe për mbulimin e shpenzimeve për investime në përmirësimin dhe rritjen e kapaciteteve infrastrukturore të QSHA-së. Çdo shërbim tjetër i ofruar nga Qendra e Shërbimeve Arsimore, në zbatim të kuartit ligjor në fuqi apo i ngarkuar nga ministri përgjegjës për arsimin, për të cilin nuk apliko-

het tarifë shërbimi sipas këtij vendimi, financohet nga fondet e buxhetit të shtetit, të miratuara për ministrinë përgjegjëse për arsimin. Sakaq të ardhurat e papërdorura gjatë një viti financiar kalojnë në vitin pasardhës. "Vendimi nr. 812, datë 10.11.2011, i Këshillit të Ministrave, "Për përcaktimin e tarifave për provimin e shtetit", shfuqizohet. 9. Ngarkohen Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë,

Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe Qendra e Shërbimeve Arsimore për zbatimin e këtij vendimi. Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare", nënvizohet në Fletoren Zyrtare.

**TARIFAT**

Njohja e diplomave, certifikatave e titujve dhe gradave të fituara në përfundim të studimeve të kryera jashtë vendit të lëshuara nga një institucion i huaj i arsimit të lartë, është 2000 lekë për çdo aplikant. Ndërkohë provimi i specializimit në mjekësi, si dhe profesione të tjera të rregulluara, tarifohet me 5000 lekë për çdo aplikant. Provime të tjera të digitalizuara, të kërkuara nga institucionet publike dhe private kushtojnë 5000 lekë për çdo aplikant, ndërsa aplikimi për ndjekjen e studimeve në

**LLOJI I SHËRBIMIT TARIFA (LEKË)**

1. Provimi i shtetit për profesionet e rregulluara:
  - a) Për provimin e shtetit dhënë nga kandidati për herë të parë: 10 000 lekë;
  - b) Për provimin e shtetit dhënë nga kandidati për herë të dytë: 12 500 lekë;
  - c) Për provimin e shtetit dhënë nga kandidati për herë të tretë: 15 000 lekë;
  - d) Për provimin e shtetit dhënë nga kandidati për herë të katërt: 17 500 lekë;
  - e) Për provimin e shtetit dhënë nga kandidati për herë të pestë: 20 000 lekë;
  - f) Për provimin e shtetit dhënë nga kandidati me shumë se pesë herë: 25 000 lekë.
2. Njohja e diplomave, certifikatave e titujve dhe gradave të fituara në përfundim të studimeve të kryera jashtë vendit të lëshuara nga një institucion i huaj i arsimit të lartë, 2 000 lekë për çdo aplikant.
3. Provimi i specializimit në mjekësi, si dhe profesione të tjera të rregulluara, 5 000 lekë për çdo aplikant.
4. Provime të tjera të digitalizuara, të kërkuara nga institucionet publike dhe private, 5 000 lekë çdo aplikant.
5. Aplikim për ndjekjen e studimeve në institucionet e arsimit të lartë në sistemin që administrohet nga QSHA-ja, 2 000 lekë për çdo aplikant.
6. Regjistrimi i formës së diplomave dhe certifikatave, 3 000 lekë për diplomë/certifikatë të regjistruar.
7. Tarifa për pajisjen me numrin unik të matrikullimit (për student) 100 lekë;
8. Pajisja e IAL-së me: 2 000 lekë;
- a) Regjistrin themeltar të studentëve (për regjistër);
- b) Regjistrin e arrijeve akademike;
- c) Regjistrin e lëshimit të diplomave dhe certifikatave.

institucionet e arsimit të lartë në sistemin që administrohet nga QSHA-ja, tarifohet me 2000 lekë për çdo aplikant. Ndërkohë regjistrimi i formës së diplomave dhe certifikatave,

tarifohet me 3000 lekë për diplomë/certifikatë të regjistruar; në një kohë që tarifa për pajisjen me numrin unik të matrikullimit është 100 lekë për çdo student.



**Serbi, aksidenti me 8 të vdekur, mes tyre dy shqiptarë**

**Mjegulla përgjak aksin rrugor Nish-Beograd, plagosen rëndë 40 persona në 34 automjete**

Ditën e martë disa persona humbën jetën në një autostradë në Serbi, ndërsa mes tyre ishin edhe dy shqiptarë të vdekur dhe dy të plagosur. Mësohet se dy viktimat nga Maqedonia janë Burim Dalipi 37 vjeç dhe Jagodinë dhe Cuprija dhe janë jashtë rrezikut për jetën, shkruan Alsat. Ministria për Punë të Jashtme e Republikës së Maqedonisë më herët kishte marrë konfirmimin më herët se dy

**MINISTRIA E PUNËVE TË BRENDSHME**

"Kemi një konfirmim telefonik nga policia në Jagodinë se për fat të keq dy qytetarë maqedonas janë vrarë në aksidentin e trafikut. Siç është edhe procedura e zakonshme, ne nuk i komunikojmë emrat e viktimave, por vetëm konfirmojmë çfarë ka ndodhur", njoftojnë nga MPJ.

shtetas maqedonas kanë ndërruar jetë në aksidentin zinxhior në autostradën Nish-Beograd. "Për momentin kemi një konfirmim telefonik nga policia në Jagodinë se për fat të keq dy qytetarë maqedonas janë vrarë në aksidentin e trafikut. Siç është edhe procedura e zakonshme, ne nuk i komunikojmë emrat e të vdekurve, vetëm se konfirmojmë çfarë ka

ndodhur", njoftojnë nga MPJ. Dje në mëngjes në spitalin e Nishit ndërroi jetë edhe një person tjetër, i cili mbeti i aksidentuar gjatë ditës së djeshme, duke e çuar në 8 numrin e viktimave. Numri i të plagosurve në aksident ka arritur në 40 persona. Rreth 34 automjete dhe kamionë u përplasën mes tyre për shkak të mjegullës së dendur.

**Zvicër, shqiptari rrefen tmerrin e aksidentit: Fat që jam gjallë**

Një shqiptar ka shpëtuar për mrekulli ditën e djeshme. Ai u përfshi në një aksident rrugor me taksì në një autostradë, teksa kishte marrë rrugën për t'u kthyer në atdhe. Mediat raportojnë se Armend Kameri ndodhet në shtratin e spitalit, por, për fat të mirë, gjendja e tij shëndetësore është e mirë dhe pa pasja për jetën. "Nuk është ndonjë çudi, unë jam ende gjallë", tha punëtori i picerisë për "Blick". Aksidenti ku u përfshi shqiptari u regjistrua në Rothrist AG, ndërsa drejtuesja e mjetit me të cilën po udhëtonte Kameri, gjeti vdekjen e menjëhershme. "Doja të shkoja në stacionin e trenit në Olten dhe pastaj të vazhdoja me tren për në aeroportin e Zyrihut. Doja të shkoja në vendlindje për një udhëtim të shkurtër. Makina u rrotullua dhe u ndal, duke qëndruar në anë. E gjitha ndodhi shumë shpejt", shtoi ai. Kosovari 21-vjeçar tregon edhe momente të frikshme kur pa taksisten, e cila kishte marrë dëmtime në kokë. "Kishte lëndime serioze në kokë", thotë ai.



**SHKURT**

**Indi, 7 të vdekur pas përplasjes së një treni**

Shtatë persona kanë vdekur dhe të paktën 30 të tjerë janë plagosur pasi treni në të cilin udhëtonin u përplas rreth orës 6:05 të mëngjesit, bën të ditur policia. Aksidenti ka ndodhur në hyrje të stacionit të Rae Bareli, rreth 80 kilometra në jug perëndim të Lucknow, kryeqytet i Shtetit të Uttar Pradesh, në Indi. Ekipet e shpëtimit nga Lucknow dhe Varanasi janë në vendin e aksidentit për të shpëtuar udhëtarët që mund të kenë mbetur të bllokuar. Dhjetë gra dhe gjashtë të mitur janë në mesin e të dëmtuarve, situata zyrtarë e hekurudhës. Të gjithë të dëmtuarit janë dërguar në spitalet e zonës. Nuk dihen ende shkaqet e aksidentit.

**Theresa May: Post-Brexit, më e mira është para nesh**

Kohërat më të mira janë përpara nesh, theksoi sot kryeministria britanike Theresa May duke u referuar çështjes postBrexit dhe premtimin për t'i dhënë fund 10 viteve të kursimit. "Ne do të shohim rënien e borxhit dhe mbështetjen për shërbimet sociale që do të rriten," siguroi kryeministria konservatore për të ardhmen e afërt, duke pranuar se ka "zgjidhje të vështira për t'u bërë në të ardhmen". Por, për udhëheqësin e opozitës laburiste, Jeremy Corbyn, fundi i masave shtrënguese "është vetëm një zhgënjim i madh nga konservatorët", raporton ATA.

**Papa kundër abortit: Është si vrasës me pagesë**

Papa Françesku gjithmonë në deklaratat e tij është shprehur kundër abortit. Më herët ai e ka quajtur atë një simptomë "të llahtarshme" të një "kulture pakujdesie", që shton shumë pak vlera në jetët njerëzore. Ndërkohë ditën e djeshme Papa ka folur sërish për abortin, duke thënë se është sikur të paguash një vrasës me pagesë. "Si mund të jetë një zgjidhje një veprim që shtyp një jetë të pafajshme ende pa lindur? Unë pyes veten. Është e drejtë që të flakësh tej një jetë për të zgjidhur problemet tuaja?! Është e njëjtë sikur të paguash një vrasës me pagesë për të vrarë dike"- ka thënë Papa.

Debati për marrëveshjen e Prespës, shumica votoi 'pro' opozitës

**Zaev: Ndryshimet kushtetuese nuk rrezikojnë identitetin**

**Çështja me Maqedoninë, Greqia çon në SHBA "planin B"**

Ditën e djeshme, komisioni për çështje kushtetuese në Kuvendin e Maqedonisë nisi debatin për fillimin e ndryshimeve kushtetuese në përputhje me marrëveshjen e Prespës për emrin me Greqinë. Në komision u paraqitën të gjithë anëtarët përfshirë edhe ata të opozitës. Shumica mbivotoi opozitën, e cila kundërshtoi rëndin e ditës. Në ekspozitë e tij, kryeministri Zoran Zaev foli për rëndësinë e ndryshimeve kushtetuese dhe nevojën e konsensusit brenda-parlamentar me qëllim realizimin e aspiratave të Maqedonisë, integrimin në NATO dhe BE. "Bëj thirrje për unitet rreth interesave shtetërore dhe kombëtare. Të japim mbështetje të fuqishme për progresin e vendit dhe të sjellim vendim të fuqishëm. Bëhuni ata që do ta çoni Maqedoninë përpara drejtë botës moderne për jetë më të mirë për të gjithë qytetarët", theksoi Zoran Zaev, kryeministër. Opozita kryesisht u fokusua në, siç e quajtën ata, dështimin e referendumit. Ish-kreu i Kuvendit, Trajko Veljanovski potencoi se qeveria mund të bëjë çfarë të dojë, por duhet ta di se nuk i ka votat e mjaftueshme për ndryshime kushtetuese. Deputetët e tjerë nga opozita u bënë thirrje kolegëve nga shumica që të mos i votojnë ndryshimet kushtetuese. Vendasët që vetë ta udhëhiqn procesin të cilin populli ua vulosi me moksksesin në referendum. Nëse vlerësoni, vazhdoni edhe tutje në këtë mënyrë, në atmosferë të mirë, por ta dini se nuk i keni 2/3 e votave për ndryshimin e Kushtetutës", tha Trajko Veljanovski, deputet i VMRO-DPMNE-së. Miratimi i nevojës për iniciimin e ndryshimeve kushtetuese në komisionin për çështje kushtetuese mund të zgjasë deri në 10 ditë. 13 deputetë janë paraqit-



Kryeministri i Maqedonisë, Zoran Zaev

**"PLANI B" PËR MAQEDONINË**

Plani parashikon formimin e një rrjeti mbrojtës kundër ndërhyrjes ruse në Ballkan dhe pro stabilitimit të Maqedonisë, duke e lënë zgjidhjen e emrit për të ardhmen. Kamenos duket se do kërkojë ratifikimin e një marrëveshjeje të përbashkët me Maqedoninë, Shqipërinë, Bullgarinë dhe në vijim edhe me Serbinë mes Greqisë. Burimet theksojnë se marrëveshja synon krijimin e një harku stabilizimi në kufijtë veriorë të Greqisë si dhe të krejt rajonit.

tur për fjalë, ndërsa shumica pret që në mos sot, deri të premtent të përmbillet debati dhe të votohet nevoja e ndry-

shimeve kushtetuese. Nga ana tjetër, kryeministri Zoran Zaev dhe deputetët e LSDM-së janë duke vazhduar negoci-

**ZORAN ZAEV**

"Bëj thirrje për unitet rreth interesave shtetërore dhe kombëtare. Të japim mbështetje të fuqishme për progresin e vendit dhe të sjellim vendim të fuqishëm. Bëhuni ata që do ta çoni Maqedoninë përpara drejt botës moderne, për jetë më të mirë për të gjithë qytetarët", - theksoi Zoran Zaev.

atat me deputetët e opozitës me qëllim sigurimin e 80 votave për miratimin e ndryshimeve. Por opozita këmbëngul se grupi parlamentar është njëzëshëm kundër ndryshimeve, raporton Alsat M. Ndërkaq ministri i Mbrojtjes së Greqisë, Panos Kamenos, deklaroi gjatë vizitës në Uashington se ka dorëzuar plan B për çështjen e Maqedonisë. Pa përcaktuar nëse e dorëzoi në State Department të SHBA apo kryeministrit grek, drafti i Panos Kamenos parashikon formimin e një rrjeti mbrojtës kundër ndërhyrjes ruse në Ballkan dhe pro stabilitimit të Maqedonisë, duke lënë

zgjidhjen e emrit për të ardhmen. Kamenos duket se do kërkojë ratifikimin e një marrëveshjeje të përbashkët me Maqedoninë, Shqipërinë, Bullgarinë dhe në vijim edhe me Serbinë mes Greqisë. Marrëveshja, theksojnë burime, synon në krijimin e një harku stabilizimi në kufijtë veriorë të Greqisë si dhe të krejt rajonit. Panos Kamenos është pozicionuar hapur kundër marrëveshjes se Prespës, duke konsideruar rezultatit e referendumit si një refuzim nga qytetarët dhe paralëlisht theksim të fenomeneve irredentiste nga qytetarët maqedonas.

RRËFEHET VELINA: JU TREGOJ PËR AVENTURËN MË TË RREZIKSHME QË KAM KALUAR

# Alesia Bami:

## Është vështirë të jesh VIP, nuk blen dot bukën pa bërë grim

"Nuk ka sekret për linjat perfekte"

Egla Xhemali

Të gjithë e njohin si velina e "Stopit", si "Miss Fotozhënia" në "Miss Universe" dhe si vajza më e ëmbël e ekranit. E kemi fjalën për Alesia Bamin. Bukuroshja vjen në një rrëfim ekskluziv për "Gazeta shqiptare" për të ndarë me ne të fshehtat e botës përtej ekranit, marrëdhëniet me Saimirin dhe Gentin përgjatë emisioneve dhe perspektivën për të ardhmen. Alesia na tregon për ofertat e shumta që i kanë ardhur, për vështirësitë e të qenit e famshme, si dhe për linjat perfekte. Bami përtej dritave të televizionit është një vajzë e thjeshtë. Sa u përket linjave perfekte, velina ndan me ne sekretin e të qenurit gjithmonë në formë, duke pohuar se ushqehet shëndetshëm dhe bën palestër. Kohën e saj të lirë e rrëmben familja, personat e saj më të shtrenjtë. Së fundmi, Alesia flet për aventurën më të rrezikshme që ka kaluar.

### Si është puna si velinë?

E lodhshme, por mbi të gjitha shumë e bukur.

### A mendon se të konsumon ekranit?

Jo, përkundrazi.

### Si i ke marrëdhëniet me Saimirin dhe Gentin?

Marrëdhëniet i kemi shumë të mira, falë Saimirit që na e bën punën shumë të lehtë.

### Çfarë mendimi ke për femrat e ekranit?

Janë shumë të mira të gjitha në llojin e vet.

### Si e shikon të ardhmen në televizion?

Duke pritur ofertën më të mirë...

### Do i thoshe "Po" drejtim-it të ndonjë formati?

Kam pasur oferta të ndryshme, do të zgjedh më të mirën pas "Stopit".

### A e ke problem ekstrava-



### gancën?

Nuk e di kë qajnë njerëzit ekstravagancë, por në qoftë se e marrim nga ana profesionale, balerinave u lejohet. Ndërsa në jetën normale nuk jam ek-

stravagante.

### Je një nga personazhet më "In" të momentit. Sa e vështirë është të jesh e famshme?

Është shumë e vështirë të

jesh person publik, pasi nuk blen dot dhe bukën pa u "ku-ruar", sepse mezi presin të të fotografojnë sa më keq (qesh). Por, është edhe pjesa tjetër e njerëzve dashamirës që të



kërkojnë foto, të përshëndesin apo komplementojnë. Për disa të tjerë, motivim për të ndjekur rrugën e artit dhe kjo më bën vërtetë të ndihem mirë.

### Cili është sekretit i linjave perfekte?

Nuk mund të them që ka ndonjë sekret, por sigurisht ushqimi i shëndetshëm, palaestra dhe sporte të ndryshme.

### Si e kalon Alesia kohën e lirë?

Kam shumë pak kohë të lirë. Atë hapësirë të lirë që kam mendohem ta kaloj sa më shumë me familjen.

### E frekuenton jetën e natës?

Pothuajse fare.

### Aventura më e rrezikshme që ke kaluar?


Hedhje me parashutë.






## Klea dhe Elgiti festojnë dyvjetorin e lidhjes

Këngëtarja e njohur Tuna Sejdi do të sjellë së shpejti bashkëpunimin e saj me artistin shqiptar nga Nju Jorku, Seven Saraçin. "Maria" mban titullin kënga e tyre më e re, e cila është punuar nga vetë Seven Saraçi në studion e tij. Klipi i këngës "Maria" pritet të jetë mjaft "i nxehtë", pasi pjesë e tij do të jetë edhe një prej modeleve më të njohur shqiptare, Vildane Zeneli. Bukuroshja ka ndarë me fansat në rrjetin social "Instagram" trailerin e klipit, në të cilin do të shfaqet në skena mjaft provokuese me Tunën. Nuk kanë qenë të pakta komentet e fansave të saj, ku më së shumti Zeneli ka marrë komplimente.



## Ku do e kalojë ditëlindjen Enca? Zbuloni vendin magjik

Më datën 19 të këtij muaji, Enca do të festojë 23-vjetorin e lindjes së saj. Megjithatë është ende herët, prej 1 muaji ajo ka filluar të planifikojë se ç'do të organizojë për ditëlindje. Së fundmi, Enca ka pyetur ndjekësit në "Instastory" se çfarë sugjerimesh kishin për vendin ku mund të bente një udhëtim ditëlindjeje. Megjithatë këngëtarja ka marrë një vendim. Nëpërmjet një tjetër postimi në 'Instastory', Enca ka lajmëruar se vendi ku ka vendosur t'i kalojë festimet e ditëlindjes është Parisi. Javën tjetër bukuroshja i lajmëron të gjithë ndjekësit e saj se do të jetë në Paris dhe se pret orientim për vendet që mund të vizitoj.



## Adelina Tahiri çmend fansat me poza provokuese

Ajo ka shumë pak kohë që ka sjellë në jetë fëmijën e saj të parë. Adelina Tahiri shumë shpejtë ka arritur të rikthejë format e saj të trupit, duke i befasuar të gjithë. Tani Adelina ka filluar të postojë edhe fotografi të saj, e së fundi është shfaqur me një 'selfie' ku shihet në një veshje të bardhë, e cila i zbulon pak nga gjoksi. Pritet që bukuroshja t'i kthehet projekteve të reja kështu që të gjithë ata që e duan këngëtarën duhet të presin surpriza.



## Renato Mekollit i marrin 'Facebook'-un, shihni ç'i postojnë në profilin e tij

Kuzhinieri, Renato Mekolli është një personazh i njohur në ekranet shqiptare. Së fundmi, në profilin e tij të Facebook-it, është hedhur një foto ku shihen një çift gjatë intimitetit në dush. "Naten e mirë", ka shkruar ai në dëfturë, por nga sa kuptohet, sigurisht që nuk është ai në foto, por me gjasë duhet të jetë një foto e marrë në internet. Gjithsesi sipas postimit të fundit të kuzhinierit në "Instagram", kuptojmë se profili i tij në 'Facebook' është hakëruar dhe nuk është çudi që çifti në dush të jetë vepër e hakerave.



## SHKRIMTARET NE DIKTATURE

*Së shpejti libri më i ri, "Shkrimtarët dhe artistët në diktatin komunist", i gazetarisht dhe studiuesit të njohur, Dashnor Kaloçi*


Letra e panjohur e Ramiz Alisë: Të dënohen Dalan Shaplllo, Llazar Siliqi, Dhurata Xoxe...

# Ramizi: Libri i Petro Markos të bëhet karton dhe asnjë kopje të mos lihet në qarkullim


*Ultimatumi i Alisë: Të tërhiqet kopja e vetme e librit të Petros nga Kosova, që në asnjë mënyrë të mos botohet atje*

Nga Dashnor Kaloçi


Trajtimi i figurës së Enver Hoxhës në një veper letrare apo dhe në artet figurative nga ana e shkrimtarëve dhe artistëve gjatë periudhës së regjimit komunist të para viteve '90-të, ishte një problem me mjaft zarr dhe paraqiste një risk të madh për autorët që merrnin përsipër trajtimin e "figurës së udhëheqësit kryesor", sidomos kur ai ishte në epiqendër të veprës si personazh kryesor i saj. Risku që mbartnin mbi vete krijuesit në rast të mos aprovimit të veprës, e cila trajtonte "figurën e udhëheqësit", nuk dëmtonte vetëm autorin e veprës, por edhe redaktorët, recensentët apo drejtuesit e Shtëpisë Botuese dhe ata të Lidhjes së Shkrimtarëve e Artistëve që kishin dhënë aprovimin për botimin e saj. Sidoqoftë kësaj, atë "risk" e patën marrë përsipër dhe provuar një numër jo i pakët shkrimtarësh e artistësh, por jo të gjithë arritën ta kalojnë me sukses "provën e zjarrit" mbi të cilën endej e ravijëzohej "figura dhe roli i udhëheqësit kryesor" në fantazinë e tyre krijuese. Ndër të parët që e pësoi këtë gjë, ishte dhe shkrimtari i njohur Petro Marko, i cili që në vitet 1972-73, në romanin e tij me temë historike, "Një emër në katër rrugë", (i cili u konsiderua si roman autobiografik, merrte përsipër e trajtonte edhe figurën e Enver Hoxhës, kryesisht për periudhën e Monarkisë së Zogut. Madje duke e trajtuar atë gati-gati si personazh kryesor të veprës së tij, e cila jo vetëm që nuk u lejua të qarkullonte pas botimit të saj nga ana e Shtëpisë Botuese "Naim Frashëri", por ajo shkaktoi një furtunë të vërtetë për të gjithë ata që lejuan botimin e saj. Dhe e gjitha kjo, pasi në veprën e tij, Petro Marko "nuk kishte trajtuar drejt figurën dhe rolin e Enver Hoxhës"? Siç duket, fati i keq vazhdoi ta ndiqte "këmba-këmbës" Petro Markon, (në vitet e para të pas Luftës, vuajti disa vjet burg politik), pasi botimi i librit të tij koncordoi edhe me fillimin e pranverës së vitit 1973, kur Enver Hoxha ndërmoi "furtunën" e madhe ndaj shkrimtarëve dhe artistëve, ku autori me origjinë nga Bregu, u ndodh papritur në qendër të atij "cikloni", madje krejt i zbuluar. Të gjitha këto dukën dhe nga këto dokumente arkivore që publikohen



Ramiz Alia



Petro Marko dhe Fatos Arapi



Petro Marko

për herë të parë dhe të plota në faqet e këtij libri, ku kërret më të lartë të udhëheqjes, duke filluar nga Ramiz Alia, Hysni Kapo, Manush Myftiu, Mantho Bala etj., kanë bërë një sërë shënimesh mbi to, duke dhënë orientimet përkatëse për dënimin e autorit Petro Marko, si dhe atyre që kishin lejuar e dhënë viston për botimin e atij libri, si: Pipi Mitrojorgji, Ali Abdihoxha, Alqi Kristo, Dilaver Dilaveri, Dhurata Xoxe, Dalan Shaplllo etj. etj. Aq i madh ka qenë alarmi i shkaktuar nga ai roman, sa që Ramiz Alia si rrallë ndonjë herë në të gjitha dokumentet që ai ka parë dhe nënshkruar, ka mbushur disa faqe të tëra me shkrimin e tij për ndëshkimin e atyre që lejuan botimin e tij, (gjë e cila duket dhe nga faksimilet përkatëse që po i publikojmë në këtë shkrim, ekskluziv për "Gazeta Shqiptare"), libër i cili pa dritën e botimit vetëm pas shembjes së regjimit komunist pas viteve '90-të.

(vijon nga numri i kaluar)


**RECENSIONI I ROMANIT TË PETRO MARKOS NGA DALAN SHAPLLLO**

**Recension për romanin "Gjikë Bua", ("Një emër në katër rrugë") Të Petro Markos**

Romani i ri i Petro Markos, që pasqyron ngjarje të periudhës së Zogut, në tërësinë e vet është një veper pozitive. Vlera e romanit lidhet me pasurinë e fakteve që sjell autori, me vërtetësinë e ngjarjeve dhe me riprodhimin besnik të atmosferës së kohës. Autori e ka pasur për qëllim të tregojë rrugën e formimit të katër fshatarëve (me emrin Gjikë), nën ndikimin e rrethanave shoqërore dhe si pasojë e karakterit të tyre. Në përgjithësi, Petro Marko ja arriti kësaj dhe tregoi formimin apo degjenerimin e këtyre tipave. Përmes faktit të tyre del tabloja e jetës asi kohe, me gjithë të palarat e oborrit, të qarqeve të shthurura, me injorancën dhe brutalitetin. Përveç kësaj autori është munduar të japë edhe lëvizjen revolucionare të kohës, njerëz të thjeshtë të popullit me ëndrrat dhe aspiratat e tyre.


Vepra është shkruar me një stil të formuar, me letërsi dhe thjeshtë. Në pjesët kryesore romani zgjon interes dhe besohet. Romani ka vlera edukative.





Po vepra ka nevojë të ripunohet në disa drejtime dhe në disa pika të rëndësishme. Ripunimi është i domosdoshëm që vepra të dalë më realiste, më bindëse dhe të jetë në nivelin e krijimeve të mira të autorit.

1. Karakteret ecin në rrugën e vet që ka si logjikë jetësore dhe artistike, por në këtë vështrim, vërehen dhe dobësitë dhe inkonsekuenca. Mirë është dhënë në përgjithësi degjenerimi i një tipi shoqëror si Argjiri. Karakteri i Mërtirit është dhënë mirë dhe ka kuptimin e vet shoqëror, por nuk është shpërthyer në fund. Kështu, Mërtiri, një njeri i ndershëm, po me luhajtje dhe dashuriçka, i mprehtë, por jo i thellë, vështirë se mund të vriste veten më 7 prill. Ose duhet ndryshuar duke e lidhur me lëvizjen përparimtare, ndryshe, duhet përgatitur shumë që të bindemi për atë gjest. Po kështu nuk i përgjigjet edhe çmenduria e xha Fotit që bënte gjithmonë shaka. Në marrëdhëniet me femrat, Mërtiri duhet të paraqitet i përmbajtur: Nuk ka sepse të takohet me Donikën, pasi ajo ka degjeneruar. Ndryshe bëhet antipatik dhe pa karakter. Po kështu duhet të zgjidhet edhe midis Qazimes dhe Marisë, sepse njëra



është e tepërt. Edhe degjenerimi i Donikës mund të tregohet më mirë, sepse kalimi të italiani, pas dashurisë me Zogun, vjen i shpejtuar dhe duket ca si meskine.

2. Vërejtjet që bëra lidhen me formicimin e realizmit të veprës. Po kështu, në këtë aspekt, autori mund të ketë parasysh edhe momente të tjera. Romani ecën në shtratin e

letërsisë me drejtim social, duke u mbështetur te parimi i historizmit. Ka edhe tendenca natyraliste, të grumbullimit dhe të futjes së materialit pa kriter, të ndodhive dhe anekdotave të shumta.

Romani mund të forcohet në realizmin e vet duke u pastruar nga anekdotizmi, nga ndodhitë e shkurtra dhe romuzet që tregohen në fshat. Disa prej tyre janë të këndshme dhe alternojnë ngjarjet e rëndësishme dhe flasin për humorin dhe vitalitetin e popullit. Por duhet ruajtur ndjenja e masës. Veç kësaj është mirë të depërtojë, herë pas here, drama e jetës, vështirësitë dhe autori të mos mbetet vetëm me intermexo humoristike.

Për të forcur realizmin e veprës dhe të trajtimit të figurave është e domosdoshme që mbreti Zog të mos nxirret vetëm me aventurat e tij ironike, po si një njeri politik, dinak, tiran dhe djallëzor në kurdisjen e planeve.

Në pjesën e parë (lidhja e Argjirit me vëllanë e Mbretit dhe Lejlanë), romani merr një udhë jo aq realiste, kalon deri diku në një loq aventure dhe sentimental si në romanet e psherëtimave mesjetare gjë që vërehet dhe në stil. Kjo pjesë mund të shkurtohet e të rregullohet, sepse në përgjithësi vepra është realiste.

3. Përshkrimi i lëvizjeve, i fillimeve të propagandës komuniste revolucionare bëhet mirë në roman dhe ndihmon në krijimin e atmos-

mund të shkurtohet mjaft: marrëdhëniet me Lejlanë dhe Xheladin, anekdotat e fshatit për historitë jashtë atdheut etj. Vepra ka mundësi të ngjishet, të çlirohet nga materiali i tepërt, të përcaktohet më mirë rruga e disa karaktereve, komentet e rralla emfatike, agjitative të shihen (sidomos fillimi dhe fundi, kur i jepet rëndësi Argjirit).

Me një punë të vëmendshme, romani do të bëhet i mirë dhe do të ndihmojë për njohjen e asaj kohe dhe për edukimin e të rinjve, të cilët, për të kuptuar më mirë të sotmen, duhet të njohin edhe të kaluarën.

Dalari Shapllon, 17 nëndor 1972


Shënimi i Ramiz Alisë

Po si autobiografi a nuk i bie në sy Dalanit. Këto të meta që thekson Dalani, a nuk janë ideologjike? A nuk i japin vullën romanit? E si atëherë është një vepër pozitive?

Ramiz

SHENIMET E RAMIZ ALISE PËR MASAT NDAJ FAJTOREVE

Shoku Pipi Lidhur me romanin e Petro Markos, siç del nga propozimet tuaja e të Ministrisë, të veprohet menjëherë:



ferës së veprës. Por, mendoj, se më shumë duhet të dalë fryma morale që është karakteristike për njerëzit e rinj. Si bartës të një ideologjie të re, të normave të reja morale, ata ishin dashur të çiltër me njëri tjetrin dhe të ndershëm në dashuri. Nuk është fjala që të krijohen marrëdhënie asketike e pedante, por për një ideal të qartë e më njerëzor. Është e nevojshme që autori të bëjë një punë të menduar mirë për të lehtësuar veprën nga erotizmi i tepërt, pa kriter, nga goditjet e Suzit (e cila nuk e meriton aq vëmendje megjithëse mund të mbetet diçka si një e vërtetë e kohës), nga afeksimi seksual i të dy motrave për Mërtirin, nga sensualizmi edhe i Mari Shirokës (që jepet kalimthi), etj. Vepra duhet të përshkohet më mirë nga një moral i ri dhe nga një atmosferë më e vërtetshme.

4. Figura e shokut Enver, në ato përmasa që e ka vënë autori mendoj se del mirë, me disa tipare të theksuara revolucionare dhe njerëzore. Por përsëri duhet menduar që të konkretizohet më tepër në ndonjë rast e sidomos pas çlirimit në bisedën me personazhet kryesore. Ky moment nuk duhet të jepet kalimthi.

5. Në mënyrë të veçantë e quaj të nevojshme të them se vepra

vërejtje që romani duhesh ndrequr: Dalani ka vërejtje të rëndësishme. Pse s'u morr parasysh? Duhet të nxirren një nga një këto vërejtje.

3) Po kështu në organizatën bazë duhet të kritikohet Llazari Siliqi e Dalan Shapllon. Llazari si redaktor kish edhe vërejtjet e recenzenëve. Pse nuk nguli këmbë të paktën t'i ndreqte, pa lere që edhe ky pranoi romanin. Dalani megjithatë bëri vërejtje, disa herë parimore, pse shfaq mendimin se romani është vepër pozitive e me vlerë, pra të botohet?

Askush nuk tërheq vëmendjen që ky libër është autobiografik. Pse kështu?

4) Duhet të merren të gjitha masat shtetërore përkatëse.

Edhe pushimi i Ali Abdihoxhës, por edhe dëmshtëpërbli. Të gjithë kanë marrë para: Që nga Petrua tek Llazari, recenzenët e redaktorët. Simbas rregullave duhet të takohet si do veprohet.


5) Libri të kalojë në karton, të prishet dhe asnjë kopje të mos lihet në qarkullim.

6) E kam thënë edhe një herë tjetër: në mbledhjen që kishim me gjithë përgjegjësit e shtypit, që në Kosovë në asnjë mënyrë nuk duhet që të dërgojmë dorëshkrime, por mund të dërgojmë kopje të librave, pasi dalin tek ne në qarkullim. Të merren masa për të tërhequr librin e Petro Markos nga Kosova. Sidoqoftë në asnjë mënyrë nuk duhet lejuar që libri të botohet atje.

7) Këto materiale që kenë në këtë dosje, t'i lexojë edhe shoku Manush, sepse Komiteti i Partisë së Tiranës duhet të jetë në dijeni dhe të ndjekë ç'bëhet në institucionet e Tiranës.

11. XII. 1973 Ramiz Alia

Me porosi të shokve Hysni dhe Shoku Manush, ju dërgoj materialin që bëjnë fjalë për romanin e P. Markos "një emër në katër rrugë." Pasi t'i lexoni ju lutem ma i ktheni.



12. XII. 1973 Pipi Mitrojorgji

SHENIMET E HYSNI KAPO SË RAMIZ ALINE SHOKU RAMIZ

Dalan Shapllon dhe Dilaver Dila-veri janë recenzen të librit që i ka ngarkuar Ndërrmarja e Botimeve. Recenzionin e kanë bërë në nëndor 1972. Pra kjo dëshmon se sa koncepte të gabuara kanë recenzenët dhe akoma më keq është për Ali Abdihoxhën, Xoxen etj, që kur kanë parë recenzen ashtu si janë bërë, në to thuhet se romani duhesh ndrequr, kurse këta e shtypin.

Unë mendoj se përveç masave shtetërore dhe materiale që duhet marrë ndaj tyre, të japin llogari edhe para organizatave bazë të partisë ku bëjnë pjesë.

Gjithë këto materiale unë mendoj që t'i shoh edhe shoku Manush, mbasi të gjithë këto kadro janë nën varësinë dhe si efektiv i Komitetit të Partisë së Tiranës dhe Partia në rreth duhet të ketë dijeni të plotë dhe të ndjekë çështjet.

11.XII.1973

Hysni Kapo



Familja e Petro Markos

## IN MEMORIAM

Nga Luan Rama

# KLOD DYRAN

## Rrëfime nga Shqipëria dhe Franca për botuesin e Fayard

Claude Durand (Klod Dyran), iku tepër herët nga kjo botë kur, ndër kohë, e kishte lënë fushën e botimeve dhe ishte hedhur në botën e shkrimit, në pasionin e tij të parë, shkrimin e romaneve, eseve dhe të teksteve historike, si 'Isha numri Një', 'Agjenti i Solzhenicinit', 'Pavioni i shkrimtarëve', etj. «Miku francez» i Shqipërisë dhe së pari i Kadaresë, na la padyshim një trisht të madh pasi, ky njeri e bëri Shqipërinë të tijen jo thjesht si një botues që interesohet për romancierin e tij (dhe ai kishte shumë romancierë të mëdhenj që kujdesej për krijimtarinë e tyre), por, sepse vërtet, edhe pse e njohu këtë vend në një epokë të errët totalitare dhe pas saj bashkë me kaosin e vet dëshpërues, përsëri ai e dëshoi shumë dhe e ndjeu si detyrë të kontribuonte disi në ripërtërtjen e këtij kombi. Ardhjet e tij në Shqipëri edhe pse në periudha të ndryshme, na kanë mbetur në kujtesë me sharmin që ai kishte, kulturën e thellë, vizionin politik të botës dhe angazhimin e tij si një njeri humanist. Miq të tillë, kur shkojnë, edhe pse ata mbeten gjithnjë në kujtesën tonë me aktet dhe kontributin e drejtpërdrejtë të tyre, lenë pas një keqardhje të thellë, si largimi i një mikut të afërt, edhe pse nuk ke mundur ta pikëtakosh drejtpërdrejt.

**"FALEMANDERIT"**

Shumë vite më parë, duke shkruar një shkrim për të, ndjesia e parë që kisha ishte t'i thosha: «Faleminderit Claude!» Biografia e botuesit të veprës së Kadaresë është pak e njohur nga intelektualët alët tanë dhe aq më tepër nga lexuesit shqiptarë. Vite më radhë, nga një dhjetëvjeçar në tjetrin, jemi gëzuar me botimet e Kadaresë në Francë dhe shpesh kemi dëgjuar emrin e botuesit të tij, Klod Dyran, por përsëri kjo figurë ka mbetur në hije dhe rrallë kemi menduar për të, vlerën e tij, komplicitetin e tij në krijimtarinë e Kadaresë, për këtë pikëtakim kaq të rëndësishëm për letërsinë shqiptare dhe vetë emrin dhe krijimtarinë e Kadaresë. Vallë sa ka bërë kritika jonë letrare për ta venë në dukje këtë fakt? Sa kanë bërë vetë shkrimtarët? Emrin e Dyran herë herë e gjejmë në ese të ndryshme të Kadaresë, impresione takimesh, pa mundur të arrijmë në refleksionin se ç'është në të vërtetë botuesi për një shkrimtar të madh, siç është Kadaresja, dhe aq më shumë për një shkrimtar të një vendi të vogël si Shqipëria. Botuesi nuk është thjesht një ent, një tregtar, apo biznesmen i një krijimtarie artistike. Botuesi është një "komplis" intim i shkrimtarit, ai e shoqëron atë, e inkurajon, e vë në dukje, bëhet një mbështetje morale për të. E padyshim, për Kadarenë ishte një fat që u pikëtakua me Dyran, drejtuesin e "Fayard" që veç romanit «Gjenrali i Ushtrisë së vdekur», (botuar nga "Albin Michel"), 1970 dhe të "Tamburet e shiut", apo "Kështjella" në shqip, botuar nga "Hachette Littérature", në vitin 1972, do të jetë ai që do të botojë pothuaj tërë veprën e shkrimtarit. Një punë e palodhshme, pasionante, gati tridhjetë vjeçare. Veç Kadaresë ai



Klod Dyran

### "Miku francez" i Shqipërisë dhe së pari, i Kadaresë

njihja asgjë nga jeta e tij: Cili ishte? Nga vinte? Çfarë pëlqente në këtë botë? Cilët shkrimtarë ishin të preferuarit e tij? A i pëlqente teatri, muzika klasike, kinemaja, ç'dinte ai për Shqipërinë?

Dyran kishte lindur më 9 nëntor 1938 në rrethinat e Parisit. Në rininë e tij ai ndoqi shkollën normale të mësuesve në Versajë dhe shpejt u dashurua pas teatrit. Nga 1991-1998 pasi drejtoi dhe shtëpinë botuese "Stock", ai kërkoi të krijojë një konstelacion botimesh rreth "Fayard", pra departament të reja si botimet Le Pommier, Pauvert, Mazarine, Mille et une nuits,


etj. Më 1994 u nderua me titullin "Chevalier de la Legion d'Honneur" dhe më pas me "Officier des Arts et Lettres" (Officer i Arteve dhe i Letërsisë). Në vitin 2014, ishte presidenti Holland që do ta dekoronte me titullin e lartë "Commandeur de la Legion d'Honneur".

**"ME KADARENË"**

Të paktë janë letrarët e mëdhenj që kanë hyrë në thellësi të jetës së Dyran. Këta janë Kadare, Garcia Marquez dhe Solzhenicini. Tre shkrimtarë të natyrave të ndryshme, dy "Nobel" dhe një pretendent prej kaq vitesh; një i "realizmit magjik"

të Amerikës latine, tjetri disident i shquar i botës staliniste dhe denoncues i gulagut totalitar, i treti shqiptar, ballkanas, evropian, me një krijimtarë tronditëse, ku mithet e legjendat, bëmat e rapsodëve dhe dramat tragjike kombëtare, janë aureola e tij. Në shkrimet e tij, herë pas here Kadareja flet dhe për Dyran, veçanërisht në udhëtimet e tij në Paris, shkuarje e ardhje mjaft të tendosura e plot mister, i ndjekur gjithnjë nga dyshimet se dikush po e përgjonte gjer në thellësi të qenies së tij, atmosferë që e gjejmë mjaft mirë në romanin e tij 'L'Ombre'. (Hija). Klod si të thuhet ishte dëshmitar i pamundësisë së lirisë së shkrimtarit në atë kohë, të atij romancieri që më pas ai do ta konsideronte si „një ndër pesë apo dhjetë shkrimtarë më të mëdhenj të botës që jetojnë aktualisht”. Në një darkë në shtëpinë e poetit dhe kritikut Alain Bosquet, ku do të ftohej Kadareja, duke pritur për një kohë të gjatë që të shfaqej shkrimtarit shqiptar, botuesi e kuptoi se ambasada shqiptare në Paris e kishte detyruar shkrimtarin të mos shkoste atje. Madje dihet fakti se kur atashu e "kulturës" së ambasadës i kërkoi atij të botonte në frëngjisht "veprën e mrekulueshme të shokut Enver Hoxha", "Hrushovianët", Dyran i ishte përgjigjur: "Nuk besoj se më intereson". "Pata përshtypjen se po më binte tavani mbi kokë", - do të shkruante për këtë episod Kadareja në Peshë e Kryqit. Mund të thuhet se pikëtakimi dhe kompliciteti i Kadaresë dhe Dyran, puna e bërë së bashku, takimet në selinë e "Fayard", në "Rue des Saints-Pères", mbrëmjet në "Lipp", "Flora", apo në "Les deux Magots", udhëtimet, ethet e një pune pasionante për afro tri dekada, duke bashkuar këtu përthyesin e famshëm Jusuf Vroni, gjithçka përbënte një libër më vete, madje dy: një i shkruar nga vetë Kadareja dhe tjetri që duhej shkruar nga Dyran.

Ata të dy u takuan së pari, në vitin 1981, atëherë kur Dyran po kujdesej për botimin e romanit 'L'Hiver de la grande solitude, kur, siç kujton Dyran, „ai ishte rrethuar nga njerëzit e ambasadës „pour écouter ce que nous disions”. „Me vdekjen e Enver Hoxhës, Ismaili kërcënohej të arrestohej, - kujton ai në një intervistë në revistën parisiane L'Oeil de Bouef, - dhe kur sulmohej me kritika të shumta në shtyp apo në gjirin e Lidhjes së Shkrimtarëve. Ishte urgjent të ndërhyhej. Kur shkoja në Shqipëri bashkë me gruan u prita në kushte të vështira dhe ishim pothuaj të izoluar në një kat të hotel „Dajti”, ku





INTERVISTA

# ROBERT BUDINA: Filmi im në festivalin "Talin" dhe beteja për teatrin

Fatmira Nikolli

RRËFIMI I REGJISORIT PËR "STREHËN MES REVE" DHE ANGAZHIMIN NË PROTESTË

askush s'mund të merrte kontakt me ne, veç njerëzve të regjimit. Por megjithatë nga prezenca dhe deklaratat e mia, ky udhëtim ndihmoi në mbrojtjen e Ismailit... Autoritetet shqiptare e kuptuan se ne ishim mjaft të vëmendshëm ndaj asaj ç'mund t'i ndodhte atij".


Më 1990, në kohën kur Ramiz Alia nisej për herë të parë në krye të një delegacioni shqiptar në mbledhjen e Këshillit të Përgjithshëm të OKB-së, në New York, Dyran e ndihmoi Ismailin në largimin e tij drejt Francës, me idenë se kjo do të përshpejtonte procesin e ndryshimeve politike edhe në këtë vend. „J'ai démissionné une bonne part des archives de Kadare dans mes bagages: treize valises... A Orly, notre équipe était un peu encombrant aux yeux des douanes françaises". Dhe Dyran do ta shoqëronte Kadarenë në gjithë atë periudhë të vështirë, por dhe të mbarsur me një veprimtari letrare e politike, që nga deklarata e tij në konferencën e shtypit në Paris ku do kërkonte azil politik e më pas me letrat drejtuar presidentëve të botës, apo për botimet e mëtejshme të Kadaresë.

Më kujtohet pranvera e vitit 1991 kur erdha në Paris me detyrën e diplomatit. Shumë miq më kishin transmetuar përshëndetje për Kadarenë. U takuam në fillim një mbrëmje vonë, në shtëpinë e kitaristit klasik Ehat Musa dhe disa ditë më pas në një apartament të Klod Dyran, diku në Bulonjë, në periferi të Parisit, pranë një kishë në avenyë Jean Jaures. Në mbrëmje, në intervionin e derës, ku duhej kërkuar emri i tij, ishte, në fakt, emri "Mozart". Kadareja ruhej ende nga frika e një reprazhjeje të ardhur nga forca të errëta, s'dihej nga. "Botuesi im Klod Dyran, - shkruan Kadare në Printemps albanais, apo 'Nga një dhjetor në tetorin', të cilit i kisha kërkuar të vinte në Tiranë, mbërriti me gruan e tij më 11 shtator. Pasi kaluam bashkë darkën, duke e çuar në hotel "Dajti", i fola për t'kjen time nga Shqipëria. Ai më dëgjo qetësisht. Ashu si dhe Michel Piccoli, ai asnjëherë nuk më kishte inkurajuar për një ndërmarje të tillë. Si mik i vërtetë që është, pa më kundërshtuar, ai më vuri në dukje vështirësitë që mund të më dilnin. Ditën tjetër, ne shkuaam të shëtisnim, duke folur në shkretëtirën e plazhit të Durrësit. Duke ecur në rërën e qullët, i thashë: mbrëmë, duke u zhytur në shtyratim tim, urreva me gjithë shpirt që dita të mos agonte më. "Të kuptoj shumë mirë më tha ai. Të nesërmen më 13 shtator i shoqërova të dy deri tek avioni bashkë me vajzën time të madhe, e cila nuk dyshonte në asgjë. Unë dhe Helena i kishim biletat për 27 shtator. Në pistën e avionit, ku më lanë të shkoja, i pëshpërita Klodit atë që i kisha thënë: nëse ekzistenca e vajzës sonë atje, pengon ardhjen time, ma dërgo atë urgjentisht! Atëherë do të detyrohem ta lë këtu, në momentin e fundit, - i thashë duke evituar fjalën "ta sakrifikoj". Ai tundi kokën në mënyrë hijerëndë dhe ne u ndamë."

I frymëzuar nga natyra, historia e zonës desha të realizoj një film të realizmit magjik dhe herë-herë surreal të rrëfyer në mënyrë shumë personale dhe subjektive përmes personazhit kryesor të filmit që quhet Besnik dhe është një bari dhe besimtar i devotshëm, i cili kalon në sprovat të vështira në raport me familjen, komunitetin, dashurinë dhe besimin në Zot". Ky është në pak fjalë filmi më i ri i Robert Budinës konkurues në një prej festivaleve më të mëdha europiane, festivali "Talin". Në një intervistë për "Gazetën Shqiptare" rrëfen filmin dhe kohën me shkrimet, projektet e protestës së pashtrur prej muajsh në mbrojtje të godinave të teatrove kombëtarë. "Personalisht për mua ka rëndësi të madhe që filmi është zgjedhur në garën zyrtare kryesore të festivalit dhe konkurrion me më të mirën që vjen nga kinemaja botërore pasi "Talin" është një nga podiumet më të rëndësishme të kinemasë botërore për momentin", thotë Budina. Në rolet kryesore interpretojnë Arben Bajraktaraj, Esela Pysqyli, Bruno Shllaku, Irena Cahani, Osman Ahmeti, Muzbajdin Qamili dhe Virus Shala.

Budina thotë se, në fakt, protesta po më pasuron jashtëzakonisht shumë për të zërthyer qenien njerëzore në planin social, politik dhe njerëzor dhe me siguri do të bëhet frymëzim për veprën e ardhshme. Unë nuk ndaj mendimin që artisti është i shkëputur si qenie sociale apo politike nga shoqëria. **"Streha mes reve", nis udhëtimin ndërkombëtar. Në kushtet kur ke kaq muaj i angazhuar me kohë të plotë në mbrojtjen e teatrove kombëtarë, ç' domethënie ka kjo për ty?**

Nisja e betejës fillimisht me mbrojtjen e ligjit të kinematografisë nga ndryshimet e deshi të bënte Ministria e Kulturës dhe më pas mbrojtjes së godinës së Teatrit Kombëtar përkoj, me kohën kur unë sapo kish përfunduar post prodhimin e filmit në Rumani. Në kushtet kur beteja me qeverinë është ashpërsuar shfaqja e filmit në Black Nights Film Festival në Tallin natyrisht që merr një domethënie të fortë, pasi është një nga 8 festivalët më të mira të filmit në Europë dhe 15 më të mirët në botë, kur revistat më të mëdha të kinemasë botërore si Variety, Hollywood Reporter apo Indwire shkruajnë. Dhe jo vetëm, vitet e fundit Tallin ka tërhequr ajkën e industrisë kine-



Robert Budina

matografike botërore ku vijnë distributorët më të mëdhenj të kinemasë dhe televizionit, pra është kthyer një nga marketet më të mëdha të filmit art në botë. Fakti tjetër që personalisht për mua ka rëndësi të madhe është që filmi është zgjedhur në garën zyrtare kryesore të festivalit dhe konkurrion me më të mirën që vjen nga kinemaja botërore pasi Tallin është një nga podiumet më të rëndësishme të kinemasë botërore për momentin. Natyrisht që kjo përzgjedhje kaq e rëndësishme më jep sigurinë që ta ruaj pavarësinë e mendimit dhe të vazhdoj betejën së bashku me shumë të tjerë kundër qeverisë, e cila kërkoi të shembë jo vetëm godinën e teatrit, por t'i japë një goditje fatale kulturës së vendit.

**"Si ka lindur "Streha mes reve"?"**  
Para disa vitesh unë isha një nga producentët e "Burrnesha" një film italian që morri pjesë në garën zyrtare në Berlin në 2015, i

cili u xhirua në Valbonë. Gjatë qëndrimit atje në kontakt edhe me historitë reale të zonës më lindi ideja të shkruaja "Streha mes reve" që ka një frymëzim direkt nga natyra dhe gjeografia e vendit atje.

Por unë doja të realizoja një film shumë personal subjektiv, i cili të kishte të veçantën e tij dhe njëkohësisht të ishte universal për një audiencë që i kalon kufijtë kombëtarë, ndaj morra përsipër të trajtoj marrëdhëniet e një individi në raport me familjen, dashurinë, komunitetin, besimin në Zot dhe natyrën.

**"Përtej sinopsit për një bari e një besimtar a qoftë edhe pronat, cili ka qenë fokusi yt?"**

I frymëzuar nga natyra, historia e zonës desha të realizoj një film të realizmit magjik dhe herë-herë surreal të rrëfyer në mënyrë shumë personale dhe subjektive përmes personazhit kryesor të filmit që quhet Besnik dhe është një bari dhe besimtar i devotshëm, i cili kalon në sprovat të vështira në raport me familjen, komunitetin, dashurinë dhe besimin në Zot.

**"Sa kohë të ka marrë ky film, ku është xhiruar, kush interpretont?"**

Puna ka filluar në mesin e vitit 2015 dhe ka përfunduar tani, pra rreth tre vjet që nga ideja fillestare deri në shpërndarjen e filmit. Në rolet kryesore interpretojnë: Arben Bajraktaraj, Esela Pysqyli, Bruno Shllaku, Irena Cahani, Osman Ahmeti, Muzbajdin Qamili dhe Virus Shala. Pastaj personazhet dytësore i morëm nga zona,

të cilët u përshtatën më së miri me aktorët kryesorë. Më ka ngelur në mendje puna përgatitore me aktorët, sepse kemi kaluar një periudhë krijuese shumë frytdhënëse dhe të bukur me njëri-tjetrin, ishim realisht si një familje e ngrohtë ku të gjithë ndihmojnë njëri-tjetrin.

**"Budina, sa të mungon sheshxhirimi në kohë proteste?"**

Në fakt, protesta po më pasuron jashtëzakonisht shumë për të zërthyer qenien njerëzore në planin social, politik dhe njerëzor dhe me siguri do të bëhet frymëzim për veprën e ardhshme. Unë nuk ndaj mendimin që artisti është i shkëputur si qenie sociale apo politike nga shoqëria, madje edhe nëse është i tillë ai përsëri është i lidhur në formë të pandarë me realitetin, por duke qenë i përfshirë direkt kupton më mirë si ndërshillet qenia njerëzore në raport me një ngjarje politike apo shoqërore, e cila nga ana e saj ndikon direkt në meta-morfozën e individit.

Gjithsesi pavarësisht protestës unë po punoj intesivisht për projektet e radhës së Erafilim qoftë si producent apo edhe si skenarist për projektin e ardhshëm.

**"Si i ke siguruar fondet për filmin?"**

Filmi është financuar nga QKK dhe RTSH dhe pjesërisht nga bashkëprodhuesi rumun DIGITAL CUBE. Ndërsa shpërndarja ndërkombëtare e filmit është bërë nga PLUTO FILM Gjermani. Distributori gjerman i filmit e ka përqyer filmin që në fillimet e tij dhe më ka asistuar përgjatë gjithë kohës që kam shkruar skenarin. Mendoj se ka qenë një siguri e madhe që filmi të përfundonte me sukses.

**"A është biznesi shqiptar dashamirës ndaj arti aq sa të kontribuojë në një film?"**

Mendoj se për momentin biznesmenët janë shumë të më të prirur ndaj artit të konsumit se sa veprave të vërteta te artit në Shqipëri, kjo vlen jo vetëm për kinemanë, por edhe për dokumentarët, teatrin apo dhe forma të tjera artistike jo shumë fitimprurëse që janë cilësore. Për këtë duhet një formim ndryshe jo vetëm i biznesmenëve, por edhe i gjithë shoqërisë dhe besoj se shpejt do të vijë edhe tek ne. Gjithsesi deri sa të vijë ajo kohë duhen disa ndryshime në ligjin për sponsorizimin dhe krijimin e formave të reja të lehtësive fiskale për të përfshirë biznesin privat në vepra cilësore, siç mund të jetë rimbursimi për një pjesë të shpenzimeve që ata mund të bëjnë në vepra të tilla. Forma të tilla ka kohë që Europa dhe bota i aplikon si një formë efektive e zhvillimit të artit të vërtetë.





Opinioni *i* Ditës

Nga Arsim Sinani

(vijon nga faqja 1)

... humbur rrugën drejt Perëndimit. Një nga shkaqet është keqpërdorimi i mjeteve i dedikuar për kampanjë, grantet dhënë OJQ-ve pa peshë nga jashtë e brenda dhe vetë kënaqësia me egon e liderit. Te shqiptarët u pa vetëm spoti me Ali Ahmetin që irritoi dhe dekura-joi votuesin shqiptar pasi që në kontinuitet ka pasur premtime dhe realizime që lënë për të dëshiruar. E kur kampanjën e drejtojnë njerëz që ia puthnin dorën Putinit sllavo-maqedonas Gruevski, s'do mend se numri i votuesve duhet të thuhet se ishte i madh.

Biçikleta me goma të plasura si model perëndimor nuk i ndihmoi njerëzve të deridjeshëm të zhytur në korrupsion të ia hedhin tutje. Ajo masa kritike shqiptare nga dëshpërimi se në pushtet mbetet mentaliteti i deridjeshëm me trastën nën dorë ia ka mësyre Perëndimit në kërkim të një jete më të mirë. Elementi i vendosjes brenda qeverisjes së shqiptarëve pa peshë politike është edhe një argument shtesë se pse referendumi dështoi. Opozita shqiptare nuk arriti të komunikojë me elektoratin pasi që mediat nuk u dhanë hapësirën minimale për ta mobilizuar elektoratin. Mediat kanë nevojë të demokratizohen dhe li-rohen nga redaktorët partiakë. Pamë analiza boshe, por nuk u shtjellua realiteti, problemet, çështjet etj. Një element tjetër që po anashkalohej ishte diaspora posaçërisht ajo shqiptare që zakonisht e mbushë arkën e shtetit e në rastin konkret iu kohua e drejta e votimit. Kur ju ia kushtëzoni votën diasporës, e cila është motor, atëherë nuk mund të priten rezultat konkret.

Diaspora shqiptare alarmoi se çështja shqiptare po anashkalohej dhe se shteti i riemëruar vazhdon me avazin e vjetër, por kjo nuk u dëgjua nga ndërkombëtarët. Ndërsa partitë shqiptare me lazdrinë e zakonshme e shtyn çështjen shqiptare pa e përdorur Badinterin pa të cilin nuk kalon asnjë ligj pa u votuar nga shumica shqiptare. Por inati i një lideri, të cilit po i fundoset anija e shtyu më tutje zgjidhjen e çështjes shqiptare. Pa e harruar atë se shqiptarët këtë herë votuan për Perëndimin e jo për marrëveshjen, e cila ishte thjeshtë kontinuitet, i cili një vetëm njëri etni dhe ndërton shtet mbijetues në shqiptarëve. Por identiteti shqiptar në FYROM është i fortë dhe imun ndaj sulmeve, por virusi i brendshëm është i paparashikuar. Shqiptarët në IRJM nuk kanë filozofi politike kjo është çështja dhe nuk është ndërthurur strategji e veprimit. Ideja e fragmentarizimit të faktorit shqiptar fatkeqësisht do vazhdojë me ritme të shpejta në FYROM.

Disa janë faktorë të kësaj: mospërgjegjësia, mungesa e kulturës demokratike, inatet e pakuptimita, mospasja doktrinë, niveli i ulët i shkollimit, dobësi i fuqisë politike si rezultat i ndikimit të faktorit sllavo-maqedon dhe bajraktarizmi pafund i liderëve etj. Mar-

# Shtatë gabimet e Zaevit



rëveshja e Prizrenit u zhbë, Marrëveshja e Ohrit nuk u zbatua, Marrëveshja e Tiranës u shkel, këshilli kordinues u prish, tryeza u shpërfill. Këto janë fakte dritëruese se kah po shkojnë shqiptarët në FYROM. Ndërsa në tabarin sllavo-maqedonas situata paraqitet mjaft problematike Shoqatat ruse dhe investimet kapitale deri në media tregoi se ishin efektive në rastin e FYROMIT. Lëvizja pansllaviste e papenguar lëvizti në zbatim më të thella duke propaganduar tezën se sllavët marrin fund nëse kyçen me Perëndimin. Këtu rol primar lozi edhe agjencitë serbe, e cila me gjithë arsenalin e saj ndikoi në bojkotin e qytetarit sllav. Ndërsa partia VMRO me njerëzit e saj u besua se çdo ndikojë, por u pa se taktika me Gruevskin pas grilave ishte bluf.

Kjo strukturë e ndihmuar nga këto forca arriti ta bllokojë procesin dhe tregoi se e do martir liderin e vet të zhytur në krim gjatë qeverisjes. VMRO mbetet e fuqishme në biznes, media, strukturat e sigurisë dhe te një pjesë e fortë e BDI-së, sepse u lidhen bizneset e punët që i kanë realizuar bashkë.

Krahu serb e rus është i fortë brenda VMRO ndërsa krahu bullgar mbetet i dobët fatkeqësisht, por edhe ai me Perëndimin. Problemi tjetër është se partia e Zaevit me shumë lehtësi iu fut referendumi pa punuar seriozisht. Partia e Zaevit nuk punoi seriozisht duke menduar se ardhja e Merkel, Mogerini ShBA e tërë botës demokratike është çështje e mbyllur. Por e harroi qytetarin e varfëruar të cilit nuk iu shpjegua çështja dhe ai mbeti i izoluar me

barkun bosh e xhepat e zbrazët. Mendjelehtësia në këtë proces e lejoi që situata të mbetet si para referendumi, nuk shihen reformat. Pasi e tjetërsoi rënien e Gruevskit Partia e Zaevit parapëlqeu t'i marrë disa shqiptarë pa influencë dhe t'i përdorë për nevoja shtetërore duke harruar se ka parti shqiptare me të cilat qeveris.

Zaevi është meritore në fitoren e vjedhur që ia bëri opozitës shqiptare duke i mbajtur në pushtet kryetarët e harxhuar të partisë së Ali Ahmetit. Ky ishte devijim dhe nënçmimi i votës shqiptare nga ana e Zaevit. Harroi ky Zaevi se ishte ky mentalitet që ia dha shkelmin paraardhësit të tij i cili fal kësaj vote iku nga pushteti. Zaevi do ishte mirë të konsolidojë elektoratin sllavo-maqedonas, i cili u pa se ka probleme të brendshme kur bëhet fjalë për integrimin e Perëndimit. Tabloja është më komplekse se kaq, por kur gomerët merren me shkencë devalvohet procesi. Perëndimi lipset t'i shikojë me kujdes njerëzve që analizat ua merr për bazë, sepse nuk dihet se ku mund ta kenë kërrthizën e lidhur litarin. 7 gabimet e Zaevit janë të riparueshme, por ai duhet ta kuptoj se shqiptarët e mbajtën kursin e Perëndimit e ai t'i kthehet elektorati të vet që me elegancë e në mënyrë të pakuptueshme devijoi deri 7% anti-NATO e BE. Realisht shqiptarët është e çuditshme, por kanë një durim pasi e dinë se sllavo-maqedonasit kanë nevojë të ndryshojnë mentalitetin, i cili e mban peng vendin.

Krahu serb e rus është i fortë brenda VMRO ndërsa krahu bullgar mbetet i dobët fatkeqësisht, por edhe ai me Perëndimin. Problemi tjetër është se partia e Zaevit me shumë lehtësi iu fut referendumi pa punuar seriozisht. Partia e Zaevit nuk punoi seriozisht duke menduar se ardhja e Merkel, Mogerini ShBA e tërë botës demokratike është çështje e mbyllur. Por e harroi qytetarin e varfëruar të cilit nuk iu shpjegua çështja dhe ai mbeti i izoluar me barkun bosh e xhepat e zbrazët.

## HOROSKOPI

### DASHI

Sjellja juaj problematike do të zgjerohet listën e "armiëve". Mbani veten nën kontroll pasi mund të bëni ndonjë veprim, për të cilin do të pendoheni më pas. Dita e duhur për të blerë artikuj, vlera e të cilëve do të rritet më pas.

### DEMI

Problemet financiare do të bëjnë që të mos mendoni në mënyrë konstruktive. Ka gjasë të merrni disa dhurata nga miqtë dhe të afërmit tuaj. Sot do të kuptoni se jeni shumë të rëndësishëm për njerëzit rreth jush.

### BINJAKET

Do të ndiheni shumë mirë nga ana shëndetësore. Ka gjasë që të debatooni me një nga prindërit tuaj. Mos u ndikoni nga të tjerët kur të merrni vendime për çështje të rëndësishme. Sot mund të konfliktoheni me partnerin/partneren tuaj.

### GAFORJA

Përdorni energjitë tuaja për të ndihmuar dikë që është në stres. Mund të arrini një marrëveshje financiare, e cila do t'ju sjellë mjaft të ardhura. Mos-marrëveshjet me personat e afër do të zgjidhen shumë shpejt.

### LUANI

Duhet të mendoni pozitivisht tekta luftoni me frikën, përndryshe do të bëheni shumë pasiv. Detyrimet familjare kërkojnë shumë vëmendje. Neglizhenca juaj do të shkaktojë probleme.

### VIRGJERESHA

Natyrë juaj e këndshme do t'i bëjë të lumtur njerëzit pranë jush. Shmangni personat që i afrohen vetëm për interes. Do të ndiheni më mirë nëse falni disa gabime në të kaluarën. Përpiquni të mos bëni komente të ashpra, pasi mund të përfshihen në një debat të fortë.

### PESHORJA

Sot do të keni kohë mjaftueshëm për t'u kujdesur për veten në përgjithësi, përfshirë këtu edhe shëndetin tuaj. Lidhja juaj e dashurisë po bëhet magjike. Këshillohuni para se të ndërmerri një vendim të rëndësishëm.

### AKREPI

Miqët do të tregohen shumë mbështetës ndaj jush duke ju bërë të lumtur. Do të fitoni para nga disa burime. Atmosfera festive në shtëpi, do t'ju ulë stresin. Bëni mirë të bëheni edhe iu pjesë e këtij ambienti dhe të mos qëndroni thjesht spektator.

### SHIGJETARI

Do të impresiononi njerëzit rreth jush me këndvështrimin tuaj pozitiv dhe me besimin në vetë. Miqtë do t'ju ndriçojnë ditën, teksa kanë menduar diçka shumë interesante për të kaluar mbremjen.

### BRICJAPI

Jepini më shumë rëndësi shëndetit sesa jetës shoqërore. Mos shpresoni për një romancë sot, pasi për disa kohë ka gjasë të qëndroni vetëm. Udhëtimet për punë do t'ju sjellin përfitim të shumta.

### UJORI

Do të çlirohni nga një sëmundje afatgjatë. Ka gjasë ta gjeni veten në një situatë shumë emocionuese. Mendohuni mirë para se t'i tregoni një informacion konfidencial bashkëshortit/bashkëshortes suaj, pasi ka gjasë t'ia tregojë dikujt tjetër.

### PESHQIT

Duhet të tregoheni shumë të guximshëm dhe të fortë, pasi do të përballeni me disa probleme. Mund ta kaloni këtë situatë duke menduar pozitivisht. Natyra juaj e mprehtë do të ndriçojë ambientin përreth jush. Jeta juaj martesore do të kulmojë me disa momente të paharueshme.

**K**ristian Panuçi nuk demoralizohet nga barazimi pa gola ndaj Jordanisë. Ndonëse përballë kishin një kundërshtar modest dhe pa emra të njohur, kuqezinjët e patën të vështirë për të gjetur rrugën e rrjetës. Eksperimentet nuk munguan as në këtë ndeshje, por italiani shprehet i kënaqur me atë që dhanë lojtarët në fushë.

**E dominuam takimin, por loja nuk ishte brilante...**  
Kemi pasur 5-6 raste për të shënuar. Kur gjendesh përballë skuadrës që mbrohet. U rreshtuan 10 lojtarë për të mbrojtur. Ramë në konfuzionin e skuadrës që mbroheshë. Gjithsesi, e merituan fitoren.  
**Eksperimentet...**  
Katër ditë për t'u rikuperuar shkojnë mirë. U kushtëzuam pak edhe nga dëmtimet, si Mihaj e Ramadani, por as Gjimshiti

**E megjithatë, trajneri e sheh me pozitivitet**

**Panuçi: Meritonim të fitonim, jam optimist para Izraelit**

nuk mendohej të luante 90 minuta. Gjithsesi, kemi disa ditë kohë për t'u rikuperuar.  
**Pse nuk luajti Hysaj? E keni mbajtur fjalimin me lojtarët, cila ka qenë përgjigja?**

Preferuam më shumë që të pushonte. Vjen nga një muaj shumë i ngarkuar, ashtu si edhe Basha me Memushajn. Ka pasur ngarkesë të madhe. Vendosa të mos luaj për këtë arsye. Për sot (dje) nuk

mund t'iu them asgjë për lojtarët. Kanë qenë serioz, dhanë gjithçka. Më vjen keq që nuk shënuam, edhe pse krijuam shumë.  
**Përdorët dy skema, cila ju pëlqeu më shumë?**  
Me mbrojtjen me 3 ishim

më pak të sforcuar, por dëmtimet na kushtëzuan dhe ndryshuam skemën në pjesën e dytë. Kur luajmë me katër, jemi më të familjarizuar dhe bëjmë shumë mirë.  
**Për sulmin?**  
Uzuni bëri ndeshje shumë të mirë, ka kualitete të mëdha. Edhe Grezda bëri shumë mirë. Kishim raste, çka është pozitive. Paraqitja e sotme (dëshme) na bën optimistë për ndeshjen në Izrael.

Kuqezinjët dominojnë, por nuk shënojnë, shtylla i mohoi golin Uzunit në të 85'-ën

**Shqipëria ngec me Jordaninë, Panuçi "luftë" me mediat**

*Në "Elbasan Arena" mbyllet gjithçka 0-0*



**S**hqipëria zhgënjën sërish, kësaj radhe ndaj një kundërshtari shumë modest, siç është Jordania. Ndonëse kuqezinjët kanë dominuar gjatë 90 minutave të luajtura në "Elbasan Arena", ata nuk kanë arritur të gjejnë rrugën e rrjetës, duke shpërdoruar raste të mira shënimi. Duke ditur që të dielën luajmë ndaj Izraelit në Ligën e Kombeve, kjo pasaktësi nuk është aspak një lajm i mirë. Në Elbasan klima është e vakët, ndërsa tifozë ka shumë pak. Jordania do krijojë rastin e parë për shënim në minutën e shtatë, ndërsa në të 10'-ën Panuçi detyrohet të largojë Mihajn e dëmtuar dhe në vend të tij hedh Veselin. Grezda shpërdoron në mënyrë të pabesueshme rastin e parë për gol në të 12'-ën, ndërsa në fund të pjesës së parë Manaj ia dorëzon topin në duar portierit Jasin. Në pjesën e dytë Panuçi do të hedhë Balajn, Ndojn dhe debutuesin Uzuni, ndërsa pikërisht shko-



drani sheh gardianin jordanëz të bëjë një pritje fantastike në të 52'-ën. Veseli ka në këmbët e tij golin e avantazhit 12 minuta më pas, por fillimisht del huq, ndërsa

më pas gjuan keq. Kuqezinjët vijojnë të këmbëngulin, por nuk do të shkojnë më larg sesa shtylla e Uzunit në minutën e 85-të. 0-0 do të mbyllet në "Elbasan Are-

na", një barazim që lë shije të hidhur pak ditë nga ndeshja vendimtare me Izraelin.  
**Abazaj ndjek ndeshjen nga tribuna**

Kristal Abazaj nuk po kalon një moment të mirë në Belgjikë, pasi me skuadrën e Anderlechtit nuk po aktivizohet. Gjithsesi, sulmuesi 22-vjeçar nuk është larg Kombëtares dhe ka qenë i grumbulluar me ekipin e Shpresave. Por Kristian Panuçi nuk e ka grumbulluar në ekipin e parë, duke bërë që ndeshjen kundër Jordanisë, sulmuesi i Anderlechtit ta ndjekë nga tribuna. Në "Elbasan Arena", Abazaj është fotografuar në tribunë për të ndjekur ndeshjen e Kombëtares në miqësoren kundër Jordanisë.  
**Panuçi braktis "Supersport"-in**  
Kristian Panuçi ka refuzuar të flasë për "Supersport" pas ndeshjes. Kjo ka sjellë menjëherë reagimin e gazetarëve dhe të panelit të

platformës dixhitale që transmeton edhe ndeshjet e Kombëtares. Ilda Bejleri, e cila e priste me mikrofon në dorë trajnerin, e ka cilësuar arrogant dhe aspak korrekt trajnerin. Ndërkohë, ish-trajneri i Kombëtares, Astrit Hafizi, e ka cilësuar të pavend sjelljen e trajnerit të Kombëtares. "Të gjithëve nuk na pëlqen të flasim kur punët nuk janë mirë, ndërkohë që jemi të detyruar të respektojmë mediat dhe opinionin publik. Sjellja e trajnerit është e papranueshme. Ai e nënvlerëson shumë Shqipërinë dhe teksa u kërkon lojtarëve të jenë profesionistë, për vete jep shembullin e kundërt. Tërësisht e papranueshme kjo sjellje. Nuk e kam parë në asnjë vend", ka thënë Hafizi ndër të tjera për "Supersport".

**PRESIDENTI I FSHF-së**

**P**residenti i FSHF-së, Armand Duka ka folur për mediat pas barazimit të Shqipërisë ndaj Jordanisë. Ai shprehet se rezultati nuk e ka kënaqur dhe u shpreh se nuk mund të gjejë ndryshimin mes kësaj paraqitjeje dhe asaj kundër Skocisë. "Rezultati nuk më pëlqeu, por pati mobilizim dhe shumë lojtarë të rinj në fushë për t'u përgatitur për Izraelin. Shpresoj ta marrin në Izrael rezultatin. Nuk e di nëse ishim më mirë se ndaj Skocisë, pasi kishim rival të dobët përballë. Kjo ndeshje

**Duka: Rezultati nuk më pëlqeu, të rinjtë po**



ishte e rëndësishme jo vetëm për përgatitjen për Izraelin, por edhe për testin e disa lojtarëve për t'i pasur si alternativa në të

ardhmen. Uzuni ishte test i mirë dhe më vjen keq për Mihajn që u dëmtua në fillim, pasi është mbrojtës i mirë", - përfun-

**MESFUSHORI I REJXHËRSAVE**

**Grezda: Luajta edhe pse isha i dëmtuar**

**E**ros Grezda ka folur për "Supersport" pas ndeshjes ndaj Jordanisë, duke u shprehur se ka luajtur edhe i dëmtuar, pasi kishte marrë një goditje në kavigj. "Trajneri deshi të provonte diçka të re. Kishim shanse, por nuk ishte pasqyra jonë. Nuk zhvilluam ndeshje të mirë dhe nuk u ndjeva mirë e nuk isha në formë pas një dëmtimi në klub që mora. Në ndeshjen me Izraelin do të jem në formën më të mirë besoj dhe do të bëjmë më mirë. Me trajnerin flasim shumë dhe tek e fundit kualiteti nuk është kryesoj. Po dhe 100% e mak-




simumin, do të të shpërblehet. As sot (dje) nuk e dhama 100% dhe shpresoj të jemi në maksimum ndaj Izraelit. Të gjithë më njihni dhe loja ime

me shpinë nuk është më e mira. Kisha kohë pa luajtur dhe me Rejnxhërsin jam aktivizuar pak minuta. Këtë pozicion që kisha sot e kam luajtur vetëm kundër Spanjës. Nuk ishte ndeshja ime më e mirë dhe shpresoj të përmirësohem. Rasti i humbur? Ishte një aksion i bukur i nisur nga Gavazaj dhe provova të gjej cepin e portës dhe ishte një gabim teknik. Ishte edhe rasti i penaltisë dhe kurrë në karrierën time nuk kam pasur ndërhyrje më të fortë nga mbrapa. Ishte penallti e pastër", u shpreh Grezda.



**Fjalëkryqi (1)**



**HORIZONTAL**

2. Një pikturë vetes.
11. Lindgren e Pippi çorapegjatës.
13. Thirre edhe këstu Persefoni.
14. Hapin ekspozitën.
16. Ruhet pa çifte.
18. Shiroka aktor.
19. Fillojnë masat.
20. Të parat në aksion.
21. Eshhtë gara më e gjatë.
25. Inicialet Pacino-s.
26. Janë sponsor të Tiranës.
28. Pavone këngëtare.
29. Kështu thirrej Marco Pantani.
30. Dieta pa ekstreme.
32. Janë salla për projeksione.
33. Duhet çarë më dritë.
36. Italia në tabela.
37. Janë katrorë në sipërfaqe.
38. Williams teniste.
40. Në fillim të verës.

41. Cocker këngëtar.
43. Të fundit në tender.
44. Janë fletë trëndafili.
48. Fillojnë ideologjinë.
49. Eshhtë krahinë e Athinës.
51. Ermi i Zola.
52. Hari spjune.
53. Janë kulla në xhami.

**VERTIKAL**

1. Njësi matëse për kondensator.
2. Artet pa re.
3. Fillojnë uraganin.
4. Nisin titrimin.
5. Janë në modë.
6. Inicialet e Kokoschka-s
7. Një mund të jetë ekspres
8. Mund të jenë ushtarake.
9. Jepen për hartim.
10. Janë të lira për hartim.
12. Eshhtë magjik ai i fatave
15. Janë aftësi prodhuese të fabrikës.
17. Një orgaizatatë humanitare
21. Janë shkurre.
22. Janë kapo kozakë.
23. Nino kompozitor.
24. Fillojnë teorinë.
27. Kryqyteti i asirëve.
31. Një verë në Paris.
32. Një vepër si romani.
34. Mbyllin një sherr
35. Kompozoi një Bolero.
37. Pak mbeturina
39. Një bëhet për të mirë.
42. Eshhtë dhomë.
44. Peter që humb hijen
45. Një pjesë e territorit.
46. Pak amerikanë.
47. Gjysmë litan.
49. Dy asa.
50. Kalimi në kufij.

**Fjalëkryqi (2)**

**HORIZONTAL**


1. Mondrian piktor.
5. Safin tenist.
9. Eshhtë e re pas Krishtit.
10. Janë grimca të familjes së adroneve të tilla.
12. Fillojnë matematikën
13. Mbarojnë fare
14. Josa trainer.
15. Në mes të dhomës.
17. Gjysma e inatit.
19. Ishin shkolla edukimi.
22. Janë ritransmetues televizivë.
24. Ishte djali që vrau Odiseun.
25. Një pjesë e opozitës
27. Një ekspres në binarë.
29. Kujt ia mbajnë... e mbështesin.
30. Mund të lakohen.
32. Një yll me bisht.
34. Italia në Internet.

**VERTIKAL**


35. Edouard piktor.
37. Shahu i fundit.
38. Gjysma e aortës.
40. Efekti... i François Truffaut.
41. Inicialet e Lendi
42. Kufizojnë një kënd.
44. Polanski regjisor.
46. Skuadër greke.
48. Britma e Arkimedit.
49. Egoyan regjisor.
50. Fillojnë turnin.

**VERTIKAL**


1. Ishte shkolla e Arkimedit.
2. Grandi këngëtare
3. Diftong teatral
4. I përkasin stinës së nxehtë.
5. Një shishe bombë.
6. Janë në qendër.
7. Ndiqet nga një mi
8. Janë këngëtarë lirikë.
10. Emër burri.
11. Një personazh i interpretuar nga Woody Allen.
15. Botom pa ekstreme.
16. Eshhtë figurë letrare.
18. Eshhtë enë kryesore gjaku.
20. Një pikë në ligj
21. Rrisa pa kufij
23. Ulen në Dhomën e lartë të tillë.
26. Janë fletë trëndafili.
28. Robert Mitchum.
29. Inicialet e Moravia-s.
31. Eshhtë si fatë.
32. Gjysma e ketrit.
33. Carolina e belle epoqe.
36. U shkrua nga Zola.
39. Me të bëhet trokë.
43. Duket të parat
45. Maten të parat.
47. Të parat në kufij.



**Gjeni ndryshimin**



Dy figurat kanë ndryshime nga njëra-tjetra



Përgjigja, ja cilat janë ndryshimet e figurave

**SUDOKU**

1	3				
	5		8		7
9	2				1
		6	4		
6	1		3	8	
				5	
1	9		2		4
4		8	5		3
5			1		

Plotësoni vendet bosh në mënyrë që çdo kolonë të ketë numrat nga 1-9

**Përgjigje e sudokut të numrit të kaluar**

5	9	3	8	7	4	1	2	6
4	6	8	3	2	1	5	7	9
7	1	2	6	5	9	8	3	4
2	4	9	7	1	6	3	5	8
8	7	6	9	3	5	2	4	1
1	3	5	2	4	8	6	9	7
6	5	4	1	9	2	7	8	3
9	8	7	5	6	3	4	1	2
3	2	1	4	8	7	9	6	5

*Argëtim filozofik*

Një person i tretë asnjëherë nuk krijon problem midis dy njerëzve. Eshhtë një problem midis të dyve që krijon hapësirë për personin e tretë

Mos u trego shumë i 'ndershëm' me të gjithë në këtë botë... Mos harro se pemët me të 'drejta' zgjidhen gjithmonë të parat për tu 'prerë'..!

Varfëria në botë nuk është për shkak se nuk mundemi të ushqejmë të varfërit, por për shkak se nuk mundemi të ngopim të pasurit

Mos e merrni për dobësi heshtjen time, se nëse unë flas, ju nuk dot të mund ta përballoni

**KRIPTOSKEME**

**KRIPTOSKEME**

Përgjigja e numrit të djeshëm

7	15	3	9	4	6	1	4	1	7	K	A	F	E	T	A	L	E	N	T				
1	15		11	8	8	6		5	L	I	M	A	A	D	A	M	P	A	F	T	E	R	
17		14	8	5	8	12	1	7	8	7		5	T	E	T	H	E	P	A	T	I	T	I
6	3	7	9	6	1	13	8	7		14	8		E	T	H	E	R	E	T	I	K	E	
17	9	6	19	13	3	7	3	7	3	7		13	G	K	O	M	I	T	E	T	E	T	
9	16	8	15	1	7	9	15	8	7		7	7	O	E	K	I	P	E	T	T	F		
6		13	3	6	13	9				12	1		R	I	K	N	E	T	T	A	P	A	
16		4	13	13	3	6	1	5	5	3			I	O	G	C	S	T	I	L			
1	6	3	1	13	7			17		9	4	8	K	P	S	W	I	N	G	S	L		
13		9	7	8	17	3	16	9	15	8			E	O	P	A	T	E	N	T	A	T	
3	7	13		8	7	3	5	8	13	3	8		N	A	Y	E	Û	R	A	T			
1	5	3	11	3		4	3	15	7	1	17	3	T	Y	M	I		P	I	R	A	T	I

**PËRGJIGJET E FJALËKRYQJEVE TË NUMRIT TË KALUAR**

S	A	R	A	B	A	D	P	L	A			
A	D	D	E	S	I	D	E	R	I	U	S	
T	E	B	U	R	I	D	A	N	I	I	K	
R	R	A	H	A	R	A	K	I	R	I	E	
A	B	A	T	E	S	J	V	I	T	E		
P	I	T	O	N	I	H	D	A	N	A	E	
H	A	S	I	M	U	R	I	A	L	T		
S	U	S	P	A	R	I	D	I	L			
A	A	I	F	A	R	I	S	E	J	T	E	
G	J	A	K	K	U	Y	P	R	O	T	E	U
K	I	N	A	P	R	O	T	E	U			
T	D	E	D	I	T	H	S	A				
C	L	A	U	D	E	K	N	G	O	L		
S	A	G	A	N	G	A	N	I	M	E	D	I
O	K	A	K	A	M	I	K	A	Z	E		
L	A	I	P	A	G	A	N	I	N	I	A	
O	K	E	A	K	A	S	I	O	M	A	R	
A	R	O	S	A	K	T	E	I	T	M		
L	O	B	T	N	R	T	E	O	A			
N	I	C	O	T	A	H	E	R	O	I		
S	T	A	U	I	P	O	N	K				
P	I	S	T	A	M	O	S	T	I	E		
Y	A	R	D	E	M	E	T	R	A			

**FJALËKRYQI (1)**

**FJALËKRYQI (2)**

*Thënie të mençura*

- Mos e hidhëro prindin tënd, për ti bërë të lumtur të tjerët, sepse dije se të tjerët nuk i sakrifikojnë jetët e tyre për të ndërtuar jetën tënde
- Parat mund të bëjnë një mashkull të pasur .. Por është edukata ajo e cila e bën Zotëri
- Sikur një femije të dorezohej që ne rezimin e tij të pare, nuk do kishte mesuar kurre te Ecte
- Gjerat me të bukura ne bote nuk mund te degojen, nuk mund te shihen as te preken..Por mund te NDJEHEN...

